



BASHKIA GJIROKASTËR

PROJEKT BUXHETI 2022

Përmbajtja

1. HYRJE	3
1.1 ROLI I BUXHETIT VJETOR QËLLIMI I TIJ DHE LIDHJA ME PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM	3
1.2 FAZAT E PËRGATITJES DHE MIRATIMIT TË PBA-SË DHE PROJEKT BUXHETIT VJETOR	5
2. PROJEKT BUXHETI 2022	6
2.1 TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET PUBLIKE TË BASHKISË GJIROKASTËR NË VITET 2022	6
2.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Gjirocastër për vitin 2022	8
2.1.2 Plani i Shpenzimeve të Bashkisë Gjirocastër për vitin 2022	37
2.2 INVESTIMET PUBLIKE NË NIVEL VENDOR	42
3. BUXHETI VJETOR	44
3.1 PROGRAMI A	44
3.1.1 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit	Error! Bookmark not defined.
3.1.2 Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit	Error! Bookmark not defined.
3.1.3 Projektet e Investimeve të Programit.....	Error! Bookmark not defined.
3.1.4 Të Dhëna mbi Programin	Error! Bookmark not defined.
3.X PROGRAMI X.....	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
4. SHTOJCA	65

1. HYRJE

1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjecare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, manaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

Plani i Përgjithshëm Vendor shpjegon atë që Bashkia synon të arrijë në fushat kryesore të ofrimit të shërbimeve, cilat struktura të Bashkisë do të përfshihen dhe si do të ndërveprojnë me organizatat e sektorit privat dhe aktorë të tjerë jopublik. Si të tilla, ato përskruajnë mënyrën sesi bashkia synon të zhvillojë komponentët kryesorë të ofrimit të shërbimeve, investimet kryesore publike që do të kërkojnë dhe implikimet përkatëse për nivelin dhe llojin e shërbimeve publike që do të ofrohen. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavjecare.

Bashkia është përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifave vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara) dhe burime të tjera sic janë grante të përfituara nga projektet me partner BE dhe jo vetëm.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Dokumenti PBA bën lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare.

Bashkia Gjirokastrë në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” siguron politika të efektshme, efikase në një nivel sa më afër qytetarve nëpërmjet shërbimeve dhe lehtësirave publike në përputhje me standartet e kërkuara me ligj, funksioneve dhe kompetencave të realizimit të detyrave si dhe nxitjen e gjithëpërfshirjes të qytetarve.

Për të përmbushur vizionin Bashkia Gjirokastrës nëpërmjet PPV të miratuar në Shtator 2017 ka zhvilluar 5 objektiva strategjike, të cilat do të udhëheqin zhvillimin në të gjithë territorin e Bashkisë për vitet në vijim. Këto objektiva paraqiten si më poshtë vijon:

Objektivi Strategjik 1: Forcimi i pozicionit kyç të Bashkisë, për tu bërë porta jugore e vendit dhe nyje për bashkëpunimin ndërkufitar. Duke forcuar në të njëjtën kohë rolin e Gjirokastrës si një qendër e turizmit rajonal dhe portë drejt destinacioneve turistike të vendit.

Buxheti bën lidhjen e politikave dhe objektivave të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor me prioritetet e Bashkisë nën tavanet buxhetore. Buxheti vjetor përbën vitin e parë të planit buxhetor afatmesëm.

Objektivi Strategjik 2: Mbrojtja dhe promovimi i mjedisit kulturor të Bashkisë dhe të trashëgimisë kulturore (numër i madh vendesh me interes historik dhe kulturor, qyteti i vjetër i Gjirokastrës- monument UNESCO), me qëllim rivitalizimin turistik të rajonit.

Objektivi Strategjik 3: Rigjenerimi ekonomik i zonës, i udhëhequr nga parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, nëpërmjet zgjerimit të bazës prodhuese dhe të zhvillimit të balancuar të tre sektorëve të prodhimit. Përveç sektorit të turizmit, Bashkia e Gjirokastrës siguron prodhime të rëndësishme bujqësore dhe aktivitet industrial, sektorë të cilët duhet gjithashtu të stimulohen. Prodhimi bujqësor është veçanërisht i rëndësishëm, duke marrë parasysh pozicionin e saj, përshkrimin e Bashkisë nga lumi Drino dhe tokat bujqësore afër tij kanë produktivitet të lartë. Në të njëjtën kohë ka edhe një sektor të fuqishëm industrial i cili është përqëndruar kryesisht përgjatë autostradës SH4.

Objektivi Strategjik 4: Mbrojtje dhe menaxhim i qëndrueshëm i mjedisit natyror, nëpërmjet evidentimit të elementëve të fortë të Bashkisë (zona e mbrojtur Kardhiq, monumente natyrore, sipërfaqe pyjore) dhe mbrojtje si e sistemeve të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore (burime, lumi Drino, liqeni Viroi), edhe të sistemit të tokës natyrore dhe bujqësore nga aktivitetet njerëzore.

Objektivi Strategjik 5: Përmirësimi i cilësisë së jetës së banorëve, nëpërmjet përbushjes së infrastrukturës teknike dhe krijimit të një niveli të lartë të infrastrukturës sociale. Paralelisht duhet të jepen mundësi më të mira punësimi dhe të ketë një rigjallërim të qytetit të Gjirokastrës nëpërmjet rigjenerimit urban.

Gjithashtu prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioritetëve vjetorë të shpenzimeve .

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxhetimi vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njësisë vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një

bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësia vendore ofron për banorët. Buxheti vjetor përbën vitin e parë të planit buxhetor afatmesëm.

1.2 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së dhe Buxhetit Vjetor.

Udhëzimi Standart i PBA-së, nr 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore” përcakton qartë fazat nëpër të cilin kalon përgatitja dhe miratimi i PBA-së dhe projekt buxhetit vendor si viti i parë i dokumentit.

Faza 1, është faza strategjike kur merren të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave dhe investimeve të reja. Kjo fazë përmbyllet me përgatitjen e projekt dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga njësia vendore për të realizuar alokimin strategjik burimeve midis programeve me qëllim përgatitjen e planeve afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetit vjetor gjatë fazës teknike të përgatitjes së këtij dokumenti. Në fund të kësaj faze, dokumenti i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të njësisë për qëllime konsultimi, si dhe dërgohet në MFE, brenda datës 1 qershor e cila përgatit komente dhe rekomandiime.

Faza 2, është faza teknike gjatë së cilës ekipet e menaxhimit të programeve të njësisë vendore marrin vendimet përfundimtare mbi planet për ofrimin e shërbimeve publike gjatë tre viteve të ardhshme. Gjatë kësaj faze përfshihen vendimet mbi përmbajtjen e projekt buxhetit vjetor që do t'i paraqiten GMS të njësisë. Në përfundim të kësaj faze, përgatitet një version i rishikuar i dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga njësia për të vendosur mbi detajet në lidhje me shërbimet publike që do ofrohen si dhe alokimin e shpenzimeve që do të bëhen pjesë e Buxhetit Vjetor. Dokumenti i Rishikuar i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të njësisë për qëllime konsultimi.

Ashtu sic përcakton edhe udhëzimi standard, gjatë periudhës Tetor-Nëntor Bashkia , merret me finalizimin e dokumentit të PBA-së, si dhe miratimin e Buxhetit Vjetor. Gjatë kësaj faze, GMS përgatit një version përfundimtar të PBA-së në përputhje me vendimet e Këshillit të Bashkisë.

Projekt buxheti Vjetor është viti i parë i Projekt Buxhetit Afatmesëm dhe i paraqitet Këshillit për miratim. Një version përfundimtar i dokumentit të PBA-së (përfshirë Buxhetin Vjetor) publikohet dhe i vihet në dispozicion publikut të gjerë përmes faqes së internetit të Bashkisë.

2. PROJEKT BUXHETI 2022 NË BASHKINË GJIROKASTËR

Njësitë e vetëqeverisjes vendore për menaxhimin e financave vendore ndjekim parimet e përcaktuara në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë dhe të mbështetur në parimin e hartimit të buxhetit vjetor dhe të PBA në parashikime realiste të të ardhurave dhe shpenzimeve. Njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat dhe tarifat vendore, nga fondet e transferuara nga buxheti i shtetit dhe fondet që vijnë drejtë për së drejti nga ndarja e taksave e tatimeve kombëtare, huammarrja vendore, donacionet si dhe burimet tjera të parashikuara në ligj.

2.1 Të Ardhurat dhe Shpenzimet Publike të Bashkisë Gjirokastër 2022.

Ky nënseksion paraqet një përshkrim të secilit prej burimeve kryesore të të ardhurave, duke përfshirë të ardhurat e veta, taksat e ndara, transfertën e përgjithshme të pakushtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuara sektoriale, transfertën e kushtëzuar, huamarrjet dhe të ardhurat e trashëguara. Informacioni jepet mbi: të ardhurat faktike të dy viteve të fundit; buxhetin fillestar dhe të pritshmin për vitin korent; dhe parashikimet për tre vitet e ardhshme.

Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme

Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin nga qeverisja qendrore transferta të pakushtëzuara të cilat përdoret në autonomi të plotë dhe transferta të kushtëzuara të cilat përdoren në mënyrë të përcaktuar nga organi që jep transfertën. Ligji i ri nr 68 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” përcakton qartë rregullat, politikat, instrumentat dhe procedurat për menaxhimin e financave publike në pushtetin vendor. Në zbatim të ligjit nr 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” transferta e pakushtëzuar në një vit buxhetor është jo më pak se 1% e produktit të brendshëm bruto. Granti i pakushtëzuar nuk mund të jetë më i vogël se shumta e grantit e shpërndarë një vit më parë. Ndarja e transfertës së pakushtëzuar ndahet midis bashkive sipas formulës e cila konsiston por nuk kushtëzohet në a) popullsinë rezidente, b) dendësinë e popullsisë, c) numrin e nxënësve në arsimin parauniversitar. Në bazë të procedurës të përcaktuar në ligj për vitin 2022 Bashkia Gjirokastër ka përfituar grant të pakushtëzuar në shumën 219 985 mijë lekë.

Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale

Në zbatim të legjislacionit në fuqi bashkitë përfitojnë transfertë të kushtëzuar për mbulimin e koston së funksioneve të deleguar dhe për projekte të vecanta të konsideruara në interes vendor ku dhe kërkohet bashkëpunimi me pushtetin vendor. Transferta specifike financon funksione të reja të transferuar në njësitë e vetëqeverisjes vendore për një periudhë tranzitore deri në përcaktimin e një skeme të qëndrueshme financimi gjithashtu financon shërbime në raste të emergjencave apo situatave të ngjashme ku dhe kërkohet bashkëpunimi i qeverisjes vendore. Transferta specifike është shpërndarë si më poshtë:

1.Konviktet e arsimit parauniversitar, të cilat megjithëse kanë qënë pjesë e Bashkisë prej vitesh, vetëm në transfertën specifike të vitit 2021 janë akorduar fonde, në një vlerë prej 18.070 mijë lekë. Për vitin 2022 janë akorduar 18.262 mijë lekë, ku përfshihen: fondet për paga dhe

sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukator), shpenzimet operative dhe shpenzimet për investime.

2.Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (PMNZSH)

Në transfertën specifike të vitit 2022, janë fondet për Policinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin me një vlerë totale 30 619 mijë lekë, ndërkohë për vitin 2021 transferta e pakushtëzuar sektoriale ishte në vlerën 29 441 mijë lekë.

Në këto fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.

3.Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor

Gjatë vitit 2021 funksioni i deleguar i arsimit parashkollorë përfitoi grant në vlerën 99 612 mijë lekë. Për vitin 2022 parashikohet fond për personelin mësimor në shumën 82 347 mijë lekë dhe për stafin mbështetës në vlerën 25 210 mijë lekë, në total 107 557 mijë lekë.

4. Personeli jomësimor në arsimin parauniversitar

Gjatë vitit 2021 funksioni i deleguar i arsimit parauniversitar përfitoi grant në vlerën 6 045 mijë lekë dhe për vitin 2022 parashikohet grant specifik në shumën 6 287 mijë lekë.

5.Rrugët rurale

Në transfertën specifike të vitit 2022, janë fondet për rrugët rurale të transferuara, në një vlerë totale 8 278 mijë lekë. Në këto fonde bëjnë pjesë fondet për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime.

6.Administrimi i pyjeve

Në transfertën specifike të vitit 2022, janë fondet për Shërbimin Pyjor me një vlerë totale 7 335 mijë lekë. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.

6.Ujitja dhe Kullimi

Në transfertën specifike të vitit 2022, janë fondet për ujitjen dhe kullimin me një vlerë totale prej 10 168 mijë lekë. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.

Burime të tjera të ardhurash

Në mbështetje të aktmarrëveshjes së lidhur midis Ambasadës Japoneze dhe Bashkisë Gjirokastër, kjo e fundit përfiton grant në vlerën 82 340 Euro. Ky grant do të shkojë për blerjen e një mjeti teknologjik të menaxhimit të mbetjeve dhe 27 kontinierësh 1100L.

Po në këtë kuadër Bashkia Gjirokastër është përfituese e fondit 2 000 000 Lekë sponsorizim nga Banka Raiffeisen për ndërtimin e dy kënde lojrash, një në lagjen “Dunavat” dhe një në lagjen “11 Janari”.

2.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Gjirokastrë për vitin 2022

Nr	LLOJI I TE ARDHURES	(1) Plani Nj.A Gjirokastrë 2022	(2) Plani Nj.Adm 2022	Totali (1+2)
	A-TE ARDHURA NGA TAKSAT	60,572	18,253	78,825
1	Takse mbi ndertesën	30,991	6,306	37,297
	a) Biznesi i vogel	7,673	1,426	9,099
	b) Biznesi i madh	5,318	2,174	7,492
	c) Familjaret	14,400	2,706	17,106
	d) Debitoret	3,600		3,600
2	Taksa e truallit	127		127
3	TVB (debitore)			-
4	Tatimi i thjeshtuar i fitimit*			-
5	Tat shitja e pas.se paluajtsh	724		724
6	Takse Regjistrim automjeti	15,718	5,522	21,240
7	Takse mbi token bujqesore		6,425	6,425
	Rezident		3,655	3,655
	Jo rezident		2,770	2,770
8	Taksë fjetje ne hotel	1,175		1,175
9	Taksë ndikimi ne Infrastruktur	5,000		5,000
10	Taksë Zenie Hapesirave publike	637		637
11	Tarife Regjistrimi	200		200
12	Të ardhura nga TAP	6,000		6,000
	B-Te ardhura jo tatimore	106,981	14,349	121,330
1	Tarifa e Pastrimit	41,150	2,513	43,663
	a) Biznesi i vogel	9,364	381	9,745
	b) Biznesi i madh	12,318	362	12,680
	c) Familjaret	14,400	1,770	16,170
	d) Debitoret	2,938		2,938
	f) Entet	2,130		2,130
2	Tarifa e Reklames	4,940	135	5,075
3	Tarifa e Ndricimit Rrugor	25,230	2,363	27,592
	a) Biznesi i vogel	6,441	213	6,654
	b) Biznesi i madh	3,506	225	3,731
	c) Familjaret	11,920	1,925	13,844
	d) Debitoret	2,403		2,403
	f) Entet	960		960
4	Tarif.infra.Arsim, sport, kulture	11,302	1,837	13,139
	a) Biznesi i vogel	1,620	132	1,752
	b) Biznesi i madh	855	101	956
	c) Familjaret	7,721	1,604	9,325
	d) Debitoret	1,106		1,106
5	Tarifa e Sherbimit Veterinar	350		350
6	Tarife e zenies se hap publike ne zonen muzeale	832		832
7	Leje Transporti	779		779
8	Leje shfrytezim karburanti	-		-
9	Leje Taksi	280		280
10	Parkimi	1,317		1,317

2.1.1.1 Të Ardhurat e Veta të Bashkisë Gjirokastrë.

Baza ligjore

Ligji nr. 9632, date 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore" (i ndryshuar) perben ligjin baze per reformat e decentralizimit te pushtetit vendor dhe percakton rregullat per ushtrimin e te drejtave dhe detyrave te njesive te qeverisjes vendore ne drejtim te krijimit te taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre. Ne te ardhurat vendore perfshihen:

- Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin
- Taksa e ndikimit ne infrastrukture per ndertimet e reja;
- Tatimi mbi token bujqesore;
- Taksa mbi ndertesën;
- Taksa mbi truallin
- Taksa (e perbashket) per transferimin e pasurise se patundshme;
- Taksa (e perbashket) per automjetet/mjetet e perdorura;
- Taksa e tabelës/reklamës;
- Taksa te perkohshme;
- Tarifa per sherbime;

Me poshte po paraqesim bazen ligjore ne te cilen eshte konsultuar dhe bazuar ne vendosjen dhe perlllogaritjen e çdo takse dhe tarife te Paketës Fiskale per vitin 2022.

Ligjet:

- ✓ Ligji nr. 9632 dt. 30.10.2006 "Per Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 9920 dt. 19.05.2008 "Per Proçedurat Tatimore ne Republiken e Shqipërisë", i ndryshuar;
- ✓ VKM nr. 132 dt. 07.03.2018 "Per metodologjine per percaktimin e vleres se taksueshme te ndertesës";
- ✓ VKM nr. 168 dt. 27.03.2019 "Taksa e ndertesës"
- ✓ VKM nr. 171 dt. 28.03.2018 "Per organizimin dhe funksionimin e Drejtorise se Pergjithshme se Taksës se Pasurise"
- ✓ Ligji nr. 8308, date 18.03.1998 "Per transportet rrugore", i ndryshuar;
- ✓ Udhezimin nr. 13786/1, dt. 27.01.2010 dhe nr. 13786/1 dt. 24.01.2010 nga Ministria e Financave;
- ✓ V.K.M nr. 344 dt. 19.04.2017 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 970, dt. 02.12.2015, te Keshillit te Ministrave, "Per percaktimin e proçedurave dhe te kushteve per dhenien e licencave per tregtimin e naftes bruto dhe nenprodukteve te saj"
- ✓ Udhezim nr. 14, dt. 30.4.2018 Per disa shtesa dhe ndryshime ne udhezimin nr. 26, dt. 04.09.2008, "Per Taksat Kombetare", i ndryshuar;
- ✓ VKM nr. 632, dt. 11.06.2009 "Per miratimin e tarifave te perdorimit te kullotave dhe livadheve per kullotje dhe kositje";
- ✓ VKM nr. 1064, dt. 22.12.2010 Per disa Ndryshime ne VKM nr.391, "Per percaktimin e Tarifave ne Sekt. e Pyjeve dhe te Kullotave";

- ✓ VKM nr. 608, dt. 05.09.2015 “Per percaktimin e procedures se kalimit te pronesis se pasurive te paluajtshme, te ndertuara deri me 10.08.1991, e te truallit funksional te tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronesis, si dhe per regjistrimin e tyre”, i ndryshuar;
- ✓ VKM nr. 970, date 02.15.2015 “Per percaktimin e procedurave dhe te kushteve per dhenien e licencave per tregtimin e naftes bruto dhe nenprodukteve te saj”, i ndryshuar;
- ✓ VKM nr.54, date 05.02.2014 “Per percaktimin e kritereve, te procedures e te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 68/2017, dt.27.04.2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore”.

Të ardhurat nga taksat e ndara

Në zbatim të ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 25 i tij shprehet:

1. Njesitë e vetëqeverisjes vendore marrin një përqindje nga taksat ose tatimet kombëtare që realizohen në juridiksionin e tyre, sipas përcaktimeve të këtij neni.
2. Taksat kombëtare që ndahen me njësitë e vetëqeverisjes vendore janë:
 - a) 97 % e të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizik dhe juridike;
 - b) 25 % e të ardhurave nga taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura;
 - c) 5 % e të ardhurave nga renta minerare, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për taksat kombëtare;
 - c) 2 % e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale.
3. Të ardhurat e arkëtuara nga taksat e ndara transferohen te njësitë e vetëqeverisjes vendore deri në fund të muajit pasardhës.
4. Në rastet e ndryshimeve në politikën fiskale, që shoqërohen me ulje të niveleve, normave dhe taksave të ndara, njësitë e vetëqeverisjes vendore kompensohen financiarisht, në përputhje me nivelin e uljes së të ardhurave.

Në mënyrë më të detajuar paraqitet si më poshtë e ndarë në:

- 1. Kapitulli I - Taksat vendore**
- 2. Kapitulli II - Tarifat vendore**
- 3. Kapitulli III – Penalitetet**

Kapitulli I: Taksat vendore

Ky kapitull trajton taksat vendore ne menyre nominale duke u nisur nga elementet:

- Lloji, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nenkategorizimet, kushtet lehtesuese, strukturat pergjegjese per vjeljen e detyrimeve dhe agjentet tatimore.

1. Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin per biznesin e vogel.

Baza ligjore;

Ligji nr.9632, dt.30.10.2006 “Per Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar me ligjin nr. 142/2015, date 17.12.2015, dhe ligjit nr. 9920 date 19.05.2008 "Per Proçedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Kategorite e bazes dhe nivelet e tatimit mbi fitimin per biznesin e vogel paraqiten si me poshte:

Tabela 1. Tatim i thjeshtuar i fitimit per biznesin e vogel.

Nr	Tatim i thjeshtuar i fitimit per biznesin e vogel	Niveli i takses
1	Me xhiro vjetore 0 -8.000.000 leke	0

Kjo takse aplikohet per te gjitha bizneset qe ushtrojne aktivitet ne territorin qe administrohet nga Bashkia Gjirokaster.

Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve, nepermjet Drejtorive Rajonale Tatimore, vepron si agjent tatimor, i ngarkuar me mbledhjen, arketimin dhe transferimin ne llogarite e buxhetit te qeverisjes vendore te te ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel.

Administrata tatimore transferon te ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit te vogel ne llogari te bashkive ose njesive administrative, ku ka vendndodhjen biznesi i taksueshem, brenda dates 10 te muajit pasardhes, kur jane arketuar taksat.

1.2.TAKSA MBI PASURINE E PALUAJTSHME.

Taksas mbi pasurine e paluajtshme i nenshtrohen te gjitha personat fizik ose juridike, vendas ose te huaj, pronare apo perdorues te pasurive te mesiperme, ne territorin e Republikes se Shqiperise, pavaresisht nga niveli i shfrytezimit te ketyre pasurive. Bejne perjashtim rastet kur ne ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin per taksen mbi pasurine e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkepronari, sipas pjeses qe zoteron, apo perdoruesi i pasurise se paluajtshme, per pasurite qe nuk jane te pajisura me dokumente pronesie.

Ne taksat mbi pasurine e paluajtshme perfshihen:

- **Taksa mbi ndertesën**
- **Taksa mbi truallin**
- **Taksa mbi token bujqesore**

Ne rast te mungeses se dokumentacionit te pronesise (ndertese, toke bujqesore, truall) perdoruesi i pasurise ben nje vetedeklarim te siperfaqes prane bashkise. Bashkia nepermjet komisionit te ngritur mund te vleresoje siperfaqen e taksueshme.

1.2.1 . TAKSA MBI NDERTESEN

Baza e takses mbi ndertesat eshte siperfaqja e ndertimit ne meter katror e nderteses ose e pjeses se saj, mbi dhe nen nivelin e tokes dhe per cdo kat. Taksas mbi ndertesat i nenshtrohen edhe taksapaguesit, te cilet kane, ne perdorim apo ne pronesi, ndertesa brenda territoreve te miratuara si fshatra turistike.

Siperfaqja e nderteses, ne perdorim apo pronesi, percaktohet ne baze te dokumenteve, qe vertetojne perdorimin ose pronesine e saj.

1. Taksas mbi ndertesat i nenshtrohen, individet, personat fizik ose juridike, vendas ose te huaj, pronare te pasurive te paluajtshme ne territorin e Republikes se Shqiperise, pavaresisht nga niveli i shfrytezimit te ketyre ndertesave, pervec rasteve kur ne kete ligj percaktohen ndryshe.
2. Taksapagues eshte individi, personi fizik ose juridik pronar i nderteses, personi qe ka aplikuar per legalizim te nderteses sipas ligjit "Per legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e

ndertimeve pa leje” ose ai qe e shfrytezon ose perdor ndertesën, nese pronari nuk mund te percaktohet ose nuk gjendet.

3. Detyrimi per taksen mbi ndertesat llogaritet si shumezim i bazes se takses me shkallen e takses mbi ndertesën.

4. Taksa vendore mbi pasurine e paluajtshme-ndertese paguhet çdo muaj.

Perjashtohen nga taksa mbi ndertesat:

- a) pronat e shtetit dhe te njesive te qeverisjes vendore, qe perdoren per qellime jofitimpruresë;
- b) pasurite ne pronesi te shtetit, te kaluara me vendim te Keshillit te Ministrave, nen administrimin e shoqerive publike shteterore;
- c) ndertesat e banimit, qe shfrytezohe nga qiramarresi me qira te paliberaizuar;
- c) banesat sociale ne pronesi te bashkive;
- d) pasurite e paluajtshme-ndertesa, prone e subjekteve juridike ose fizik, qe ne baze te marreveshjeve me bashkite perdoren nga keto te fundit si banesa sociale;
- dh) ndertesat qe perdoren nga komunitetet fetare, ne funksion te veprimtarise se tyre;
- e) strukturat akomoduese “Hotel/Resort me kater dhe pese yje, status special”, sipas percaktimit ne legjislacionin e fushes se turizmit dhe qe jane mbajtes te nje marke tregtare te regjistruar dhe njohur nderkombetarisht “brand name”;
- e) ndertesat e banimit te kryefamiljareve qe perfitojne pension pleqerie ose pension social, qe jane me banim ne fshat ose qytet, kur familja perbehet vetem nga pensionistet;
- t) ndertesat e banimit te kryefamiljareve qe trajtohen me ndihme ekonomike;
- g) ndertesat kulturore, nen mbrojtje te perkohshme ose te perhershme, per kohen ne te cilen deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit ne fuqi per monumentet e kultures dhe/ose trashegimine kulturore.

Shkalla e takses mbi ndertesat, e cila aplikohet si perqindje e bazes se takses, eshte si me poshte:

1. **0,05%**, per ndertesën/njesine pronesore qe perdoret, shfrytezohe per banim;
2. **0,2%**, per ndertesën/njesine pronesore qe perdoret, shfrytezohe per veprimtari ekonomike; Siperfaqe per tregeti e sherbime, ndertim, siperfaqe prodhimi, zona muzeale do te jete 185 leke/m², ndersa per veprimtari bujqesore dhe blegtorale do te jete 37 leke/m².
3. **30%** e shkalles se takses perkatese, per te gjithë siperfaqen ndertimore, per te cilen zhvilluesi eshte pajisur me leje ndertimi dhe nuk ka arritur ta perfundoje ate, sipas afatit te percaktuar ne aktin e miratimit te kerkeses per leje ndertimi. (Ketu perfshihen edhe siperfaqet te cilat jane te pashfrytezueshme).

Nese identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet te percaktohet siperfaqja e ndertesës/njesise pronesore, perdoren vlerat referuese per siperfaqe, si me poshte vijon:

- a) 100 (njqind) meter katror siperfaqe per njesi pronesore, per ndertesat per banim.
- b) 70 (shtatedhjete) meter katror siperfaqe per njesi pronesore, per ndertesat per banim, te privatizuara me ligjin nr.7652, date 23.12.1992, “Per privatizimin e banesave shteterore”, te ndryshuar.

Tabela 2. Taksa mbi ndertesat

Taksa mbi ndertesat	Shkalla e takses	Niveli i takses
a-Ndertesa banimi (70 m) pa vertetim hipotekor para vitit 1993	0.05 %	24 leke/m ²

b. Ndertesa banimi (100 m) pa vertetim hipotekor pas vitit 1993		
a/1 Ndertesa banimi para 1993 (ne baze te vertetimit hipotekor te paraqitur nga qytetari)	0.05 %	24 leke/m ²
b/1 Ndertesa banimi pas 1993 (ne baze te vertetimit hipotekor te paraqitur nga qytetari)	0.05 %	24 leke/m ²
d-Siperfaqe per tregeti e sherbime, ndertim, siperfaqe prodhimi, Zona muzeale.	0.2%	185 leke/m ²
c-Siperfaqe per veprimtari bujqesore dhe blegtorale	0.2%	37 leke/m ²

2.b) Taksa mbi token bujqesore.

Baza e taksës mbi token bujqesore është siperfaqja e tokës bujqesore, në hektar, në pronësi në përdorim të taksapaguesit. Siperfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vertetojnë ato. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësive, përdoruesi i tokës bujqesore bën një vetedeklarim të siperfaqes së tokës bujqesore, pranë bashkisë ku ndodhet toka.

Niveli i taksës caktohet në leke për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, janë si më poshtë:

Tabela 3. Taksa mbi token bujqesore

Kategorite e tokës bujqesore	Leke/ha/vit
I	2.800
II	2.100
III	1.400
IV	1.350
V	1.250
VI	1.200
VII-X	1.100

Perjashtohen nga taksa tokat bujqesore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi token bujqesore është Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Lishencave.

2. C TAKSA MBI TRUALLIN.

Baza ligjore: Ligji nr.9632, dt. 30.10.2006 “Per Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar me ligjin nr. 142/2015, "Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr. 9632, date 30.10.2006, “Per Sistemin e Taksave Vendore”, te dates 17.12.2015.

“Truall”, eshte nje siperfaqe toke, jo bujqesore, qe ndodhet brenda vijes kufizuese te ndertimit, e percaktuar nepermjet dokumenteve ligjore te planifikimit, e miratuar per te ndertuar mbi te.

Baza e takses mbi truallin eshte siperfaqja e truallit, ne hektar, ne pronesi apo perdorim te taksapaguesit. Siperfaqja e truallit ne pronesi percaktohet sipas dokumenteve qe e vertetojne ate. Ne rast te mungeses se dokumentacionit te pronesise, perdoruesi i truallit ben nje vetedeklarim te siperfaqes se truallit ne perdorim, prane bashkise ku ndodhet trualli. Kategorite minimale te truallit jane si me poshte:

Tabela 4. Taksa e truallit

	Vlera e takses ne leke/m²/vit per qellime banimi nga individet	Vlera e takses ne leke/m²/vit per qellime biznesi
Bashkia	0,28 leke/m²	15 leke/m²
Gjirokaster		

Struktura e ngarkuar per vjeljen e takses mbi truallin eshte Drejtoria e te Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Lishencave .

2. TAKSA E TABELES

1. Taksa e tabeles zbatohet per te gjithë subjektet, te cilet vendosin tabela, te levizshme apo te palevizshme, per te identifikuar veprimtarine e tyre ose per qellime reklamimi te veprimtarise se tyre apo dhe per te trette, qe vendosen ne pamjen ballore te vendodhjes se veprimtarise, ose brenda territorit te perbashket ne qendrat tregtare, ose ne hapesira jashte vendodhjes se veprimtarise, qofshin keto publike ose private.

2. Tabelat kategorizohen ne:

i) Tabele per qellime identifikimi te veprimtarise se subjektit, e trupezuar ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria dhe qe nuk perdoret per te reklamuar veprimtarite e te tretteve. Ne te tilla tabela shenohet emri ose logo dhe/ose veprimtaria e subjektit. Ne rastin e perdorimit te me shume se nje table identifikuese, vetem njera do te konsiderohet e tille.

ii) Tabele per qellime identifikimi jashte territorit ku zhvillohet veprimtaria e subjektit ne formen dhe permasat e tabelave per orientim. Keto tabela sherbejne vetem si tabela orientuese dhe vendosen jashte territorit ku zhvillohet aktiviteti, per orientimin e klienteles apo te publikut drejt vendndodhjes se veprimtarise se subjektit.

iii) Tabele per qellime reklamimi, e levizshme ose e palevizshme, e vendosur ne pamje ballore ose jo ballore ne vendin ku zhvillohet veprimtaria e subjektit, ose ne hapesira te perbashketa ne qendrat tregtare, ose ne hapesira te tjera publike apo private, si ne tarraca, llozhe, ballkone, fasada, trotuare, shtylla, mbajttese ajrore mbi pjese te rugeve qytetase apo kombetare, etj., qe kane permbajtje reklamimi per vete apo te tretet dhe qe sherben si reklame per te njoftuar, terhequr vemendjen ose per te joshur bleresit.

iv) Tabele ne funksion te ekspozimeve te ndryshme te hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.

3. Taksa e tabelës është takse vjetore. Ben perjashtim rasti kur tabela vendoset ne funksion te ekspozimeve te ndryshme te hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj., per te cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetem per periudhen kohore te lejes se dhene nga njesia e veteqeverisjes vendore.

4. Tabela permban shkronja, logo, simbole apo figura, qe mundesojne identifikimin e veprimtarise se taksapaguesit, apo qe sherbejne per qellim orientimi, reklamimi ose ekspozimi. Si baze vleresimi per llogaritjen e takses, sherben siperfaqja ne meter katror qe ze tabela ne te gjithë shtrirjen e saj.

Ne rastin kur tabela perbehet vetem nga germa te veçuara, simbole, logo apo figura te vendosura, te gdhendura, apo te pikturuara mbi nje siperfaqe ekzistuese, si mur, fasade te jashtme te çdo lloji, shtylle, kollone, apo te ngjashme me to, dhe jo nga nje siperfaqe e vetme e shtrire te shkruar, stampuar, apo pikturuar brenda saj, e cila vendoset mbi nje siperfaqe ekzistuese, si baze vleresimi per llogaritjen e takses sherben siperfaqja qe zene te gjitha shkronjat, figurat, logo dhe simbolet qe formojne tabelen.

Kur ne siperfaqen e tabelës identifikuese perfshihen edhe germa, simbole dhe figura per qellime reklamimi te nje apo me shume produktesh apo sherbimesh qe fumizohen nga vete njesia ku është vendosur tabela, kjo tabele vleresohet si tabele identifikuese dhe taksa llogaritet per kete kategori tabele.

Ne rast te kundert, tabela vleresohet si tabele reklamimi dhe taksa llogaritet per tabelen per qellime reklamimi.

Ne rast te perdorimit nga taksapaguesi te me shume se nje tabele identifikuese, pervec atyre orientuese, vleresohet si tabele identifikuese vetem ajo tabele qe është e trupezuar ose jo ne njesine apo brenda territorit ku ushtrohet veprimtaria e taksapaguesit, ose qe ndodhet me prane njesise, ose vetem nje nga tabelat, kur ka me shume se nje te tille ne njesine apo territorin ku ushtrohet veprimtaria e tij.

Çdo tabele tjeter e tille konsiderohet si tabele per qellime reklamimi dhe taksa llogaritet dhe paguhet per kete kategori tabele. Kjo takse aplikohet per te gjitha subjektet fizik, juridike, private e shteterore, vendas apo te huaj qe kryejne veprimtarine e tyre brenda territorit te Bashkise Gjirokaster.

Niveli i kesaj takse per Bashkine Gjirokaster është si me poshte vijon :

Tabela nr.5.Taksa e tabelës

Nr	Llojet e tabelave	Nj/matese	Niveli i takses
1	Takse tabele per qellime identifikimi te trupezuara ose jo,brenda territorit ,ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe qe nuk perdoret per te reklamuar veprimtarite e te treteve (ku shenohet emri dhe /ose aktiviteti i biznesit)		
a	Deri ne 2 m ²	Leke/m ²	0
b	Mbi 2m² deri 10 m²		
	e thjeshte (pa ndriçim)	Leke/m ²	10.000
	e thjeshte (pa ndriçim)	Leke/m ²	15.000
	-elektronike	Leke/m ²	20.000
c	Mbi 10m² deri 20 m²		
	e thjeshte (pa ndriçim)	Leke/m ²	8.500

	e thjeshte (pa ndriçim)	Leke/m ²	12.750
	-elektronike	Leke/m ²	17.000
d	Mbi 20m² deri 40 m²		
	e thjeshte (pa ndriçim)	Leke/m ²	5.500
	e thjeshte (pa ndriçim)	Leke/m ²	8.250
	-elektronike	Leke/m ²	11.000
e	Mbi 40 m²		
	e thjeshte (pa ndriçim)	Leke/m ²	4.000
	e thjeshte (pa ndriçim)	Leke/m ²	6.000
	-elektronike	Leke/m ²	8.000
2	Tabele per qellime reklamimi e levizshme e palevizshme deri ne tavanin maksimal 35 m²		
	- E thjeshte (me/pa ndriçimi)	Leke/m ² /vit	22.500
	- Elektronike	Leke/m ² /vit	45.000
3	Tabela ne funksion te ekspozimeve te ndryshme te hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.		
	- Te te gjitha llojeve dhe permasave	Leke/m ² /dite	1.000

Detyrimi dhe kestet e pageses:

- Detyrimi i takses se tabelës për qellime reklamimi për subjektet që aktiviteti kryesor i tyre është reklamimi do të ndahet në katër keste 3-mujore sipas akt-marreveshjeve të lidhura me Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Lishencave.
- Për subjektet e reja të hapura gjatë vitit, taksa e tabelës do të llogaritet proporcionalisht me ditët e ushtrimit të aktivitetit, pra që nga data e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e takses së tabelës është Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Lishencave .

3. TAKSA MBI KALIMIN E SE DREJTËS SE PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

- Taksa mbi kalimin e se drejtës së pronësive për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të se drejtës së pronësive mbi to.
- Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësive mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
- Baza e takses mbi kalimin e të drejtës së pronësive për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e se ciles transferohet.
- Baza e takses për kalimin e të drejtës së pronësive për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre, dhe niveli tregues i takses është 2 % për qind.
- Vjelja e kesaj takse bëhet nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, të cilat, në rolin e agjentit të taksave, përfitojnë 3% të shumës së arketuar dhe diferencën e derdhit për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë Gjirokastrë, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

Tabela nr.6.Taksa mbi kalimin e se drejtes se pronesis.

Nr	Kategoria	Njesia matjes	Niveli i takses
1	Ndertesa banimi	Leke/m ²	300
2	Ndertesa per tregti dhe sherbime	Leke/m ²	700
3	Ndertesa te tjera	Leke/m ²	500

4. TAKSA E NDIKIMIT NE INFRASTRUKTURE NGA NDERTIMET E REJA

Tabela e meposhtme na njeh me bazen e takses se ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja, te percaktuara ne ligjin 95/2018 date 13.12.2018, per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr. 9632, date 30.10.2006 “Per Sistemin e Taksave Vendore”, te ndryshuar, si dhe disa sherbime te tjera te Drejtorise se Urbanistikes dhe Inspektoriatit te Mbrotjes se Territorrit Vendor.

Tabela nr.7 .Taksa ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja dhe sherbime te tjera

Nr	Taksa e ndikimit ne infrastrukture	Niveli i takses	Baza e takses/tarifes
	- Ndertime per qellime banimi, tregeti, sherbimi (deri ne 250 m ²)	Cmimin e shitjes per m ²	4%
	- Ndertime per qellime banimi, tregeti, sherbimi (mbi 250 m ²)	Cmimin e shitjes per m ²	8 % (jo me pak se 30.000 leke)
	- Ndertime per qellime turizmi, industri, bujqesi, ndertues individual per banim	Mbi vleften e investimit	3 %
	-Ndertime per qellime publike per projekte ne infrastrukture per te gjitha llojet	Mbi vleften e investimit	0.1 %
	-Objekt i pare legalizim	Mbi vleften e investimit	0.5 %
	-Objekte te dyta e me radhe per legalizim	Mbi vleften e investimit	8 %
	-Ndertime ne Qendren Historike per banim	Mbi vleften e investimit	2 %
	- Ndertime ne Qendren Historike per hoteleri etj	Mbi vleften e investimit	3 %
	-Objekte banimi ne zona malore	Mbi vleften e investimit	1 %
	-Hotele/Resort me 5 yje status special (brand name)	Mbi vleften e investimit	0 %
	-Objekte certifikuar agroturizem sipas ligjit per turizmin	Mbi vleften e investimit	0 %
	-Ndertimet e reja per shoqerite me kapital te zoteruar nga Bashkia Gjirokaster ne masen 100 % dhe ndermarjet e B.Gjirokaster per te gjitha ndertimet e reja apo nderhyrjet rehabilituese ne infrastrukturen ku	Mbi vleften e investimit	0 %

	investitor apo perfitues i nje projekti te financuar nepermjet marreveshjeve, granteve apo huave		
	Tarife sherbimi per dhenie leje zhvillimi		
	1- Kur zhvilluesi eshte individ		
	a-Per ndertesa 1-3 kate mbi toke	Leke	10.000
	b-Per ndertesa mbi 3 kate mbi toke	Leke	10.000
	c-Per infrastrukture	Leke	10.000
	2- Kur zhvilluesi eshte subjekt		
	a-Per ndertesa 1-3 kate mbi toke	Leke	10.000
	b-Per ndertesa mbi 3 kate mbi toke	Leke	30.000
	c-Per infrastrukture	Leke	20.000
	Tarife aplikimi per sherbimet e meposhtme te ofruara nepermjet sistemit elektronik te lejeve		
	1- Kur zhvilluesi eshte individ		
	a-Deklarate paraprake per kryerje punimesh	Leke	5.000
	b-Leje zhvillimi	Leke	10'000
	c-Leje per ndryshimin e funksionit	Leke	5.000
	ç-Leje ndertimi per ndertim te ri, me siperfaqe deri ne 250 m²	Leke	5.000
	d-Leje ndertimi per shtese ne ndertim ekzistues, me siperfaqe deri ne 250 m²	Leke	5.000
	dh-Leje ndertimi per ndertim te ri, me siperfaqe me te madhe se 250 m²	Leke	5.000
	e-Leje ndertimi per shtese ne ndertim ekzistues, me siperfaqe me te madhe se 250 m²	Leke	5.000
	f-Leje per shtyrjen e afatit te lejes se ndertimit	Leke	5.000
	g-Çertifikate perdorimi	Leke	5.000
	gj-Leje ndertimi per prishje ndertimi ekzistues	Leke	5.000
	h-Leje ndertimi per rikonstrukcion pa ndryshim funksioni	Leke	5.000
	i-Leje ndertimi per rikonstrukcion me ndryshim funksioni	Leke	5.000
	j-Leje infrastrukture	Leke	5.000
	i-Leje per ndryshimin e subjektit zhvillues	Leke	5.000
	k-Leje per ndryshimin e projektit gjate ndertimit	Leke	5.000
	l-Njoftim per fillimin e punimeve	Leke	1.000
	ll-Njoftim per ndryshimin e subjektit zbatues	Leke	1.000
	m-Njoftim per raportin e mbikqyrjes	Leke	1.000
	n-Njoftim per raportin e kolaudimit	Leke	1.000
	2- Kur zhvilluesi eshte subjekt		
	a-Deklarate paraprake per kryerje punimesh	Leke	10.000
	b-Leje zhvillimi	Leke	10.000
	c-Leje per ndryshimin e funksionit	Leke	10.000
	ç-Leje ndertimi per ndertim te ri, me siperfaqe deri ne 250 m²	Leke	10.000
	d-Leje ndertimi per shtese ne ndertim ekzistues, me siperfaqe deri ne 250 m²	Leke	10.000
	dh-Leje ndertimi per ndertim te ri, me siperfaqe me te madhe se 250 m²	Leke	10.000

e-Leje ndertimi per shtese ne ndertim ekzistues, me siperfaqe me te madhe se 250 m ²	Leke	10.000
f-Leje per shtyrjen e afatit te lejes se ndertimit	Leke	10.000
g-Certifikate perdorimi	Leke	10.000
gj-Leje ndertimi per prishje ndertimi ekzistues	Leke	10.000
h-Leje ndertimi per rikonstrukcion pa ndryshim funksioni	Leke	10.000
i-Leje ndertimi per rikonstrukcion me ndryshim funksioni	Leke	10.000
j-Leje infrastrukture	Leke	10.000
k-Leje per ndryshimin e subjektit zhvillues	Leke	10.000
l-Leje per ndryshimin e projektit gjate ndertimit	Leke	10.000
ll-Njoftim per fillimin e punimeve	Leke	1.000
m-Njoftim per ndryshimin e subjektit zbatues	Leke	1.000
n-Njoftim per raportin e mbikqyrjes	Leke	1.000
o-Njoftim per raportin e kolaudimit	Leke	1.000
Tarife sherbimi per :		
a-Kryerje punimesh per te cilat nuk eshte e nevojshme pajisja me leje ndertimi apo deklarate paraprake per kryerje punimesh	Leke	2.000
Tarifa per dhenie fotokopje te njesuar		
a.Tarife per dhenie dokumenta nga arkiva	Leke	300
b.Fotokopje e njesuar 1:500 v.1938-1988, format A4.	Leke	200
c.Fotokopje te studimeve urbanistike ne fuqi, ne format A3	Leke	300
d.Fotokopje te studimeve urbanistike ne fuqi, ne format A4	Leke	200
e.Fotokopje e çdo dokumenti te njesuar, format A4	Leke	200
f.Fotokopje e çdo dokumenti te njesuar, format A3	Leke	300
-Vendim per leje ndertimi te cdo lloji	Cdo sherbim	10.000
-Certifikate perdorimi	Cdo sherbim	10.000
-Vendim per ndryshim projekti	Cdo sherbim	10.000
-Konfirmim kufijsh per banesa dhe toka bujqesore	Cdo sherbim	500
-Proces-verbal dorezimi pasurie te paluajtshme	Cdo sherbim	15.000
-Vendim VKM nr. 608	Cdo sherbim	10.000
-Vendim VKM nr. 329	Cdo sherbim	10.000
-Konfirmim te objekteve ne proces legalizimi	Cdo sherbim	500

Struktura e ngarkuar per vjeljen e takses se ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja, eshte Drejtoria e te Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Lishencave .

5. TAKSA E FJETJES NE HOTEL

Qëllimi i programit 01110 është përmirësimi i menaxhimit dhe administrimit të Bashkisë nëpërmjet zbatimit të mandatit të saj me profesionalizëm, integritet dhe ndershmëri, duke krijuar besim tek qytetarët, duke iu përgjigjur në mënyrë të kënaqshme publikut.

Objektivi për këtë program është përmirësimi i efektivitetit të praktikave të menaxhimit dhe administrimit të bashkisë nëpërmjet zbatimit të aspekteve në zhvillimin e burimeve njerëzore, zhvillimin e parteneriteteve dhe përdorimin e resurseve me vendime efektive të marra mbi bazën e analizës së të dhënave.

Për vitin 2022 buxheti vjetor parashikon financimin e produkteve dhe aktiviteteve të cilat ndikojnë drejt për së drejti dhe indirekt në ofrimin e shërbimeve bazë që Bashkia ofron.

Disa nga produktet bazë të objektivit të programit 01110 janë si më poshtë ;

- Zhvillimi i mardhënieve të partenteteve nëpërmjet përfshirjes në organizata kombëtare dhe ndërkombëtare
- Shërbime të ofruara nga stafi i lartë menaxherial kundrejt administratës dhe komunitetit.

- Menaxhimi i punëve njerëzore përmes zhvillimit, vlerësimit të performancës, përfshirjes dhe krijimit të ambienteve të punës me standarde.
- Ofrimi i shërbimeve financiare përmes vlerësimit të dokumentit, përgatitjes së procesit dhe ekzekutimit të veprimit mbi bazën e të dhënave.
- Administrimi i dokumentacionit, përgatitja e dosjeve sipas përcaktimeve ligjore, arkivimi dhe ruajtja e tyre.
- Ngritja e praktikave më të mira të menaxhimit të procedurave për përthithjen e fondeve të huaja, me qëllim realizimin e përmirësimit të infrastrukturës që nuk mund të mbulohej me fondet e veta.
- Strategji afatmesme e Bashkisë mbi funksionimin e sektorëve menaxherial të përcaktuar në ligjin 10296, i ndryshuar.
- Dokument PBA i përgatitur me përfshirje maksimale të aktorëve të brendshëm dhe të jashtë dhe miratimi i tij në Këshill.
- Katër raporte katër-mujore të monitorimit të buxheit të përgatitur dhe të dorëzuar në KB, MFE dhe publikimi në ëeb.
- Anëtarë të stafit të trajnuar në fushën e planifikimit buxhetor dhe sistemeve financiare.
- Raporte auditimi të brendshëm të Bashkisë në lidhje me sistemet e menaxhimit.

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit mbi aktmarrëveshjen e lidhur midis ADF, TID dhe Bashkisë Gjirokastrë, kjo e fundit në kuadër të aktiviteteve kulturore të zhvillimit të turizmit në qendrën muzeale akordon fondin prej 2 000 000 Lekë. Fondi i akorduar në mbështetje të TID Gjirokastra do të lëvrohet për këtë të fundit 1 000 000 Lekë në mbështetje të aktmarrëveshjes dhe 1 000 000 Lekë për bashkëfinancim të aktiviteteve që Bashkia Gjirokastrë parashikon të zhvillojë në bashkëpunim me TID Gjirokastra.

Programi 03140

Përshkrim i Përgjithshëm i Programit		
Programi mbulon shërbimet policore që janë të nevojshme për ruajtjen e rendit publik dhe për parandalimin dhe zbulimin e krimeve. Në veçanti, policia është përgjegjëse për të mbrojtur jetën, lirinë dhe pronën e njerëzve.		
Kodi i Programit	Emri i Programit	Përshkrimi i Programit
03140	Shërbimi policisë vendore	<ul style="list-style-type: none"> • Ka për detyrë të kryejë funksione në shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të bashkisë, në përputhje me dispozitat ligjore, kur ata nuk janë në kompetencë të ndonjë autoriteti tjetër shtetëror; Të realizojë zbatimin efektiv të akteve të nxjerra nga Kryetari i Bashkisë dhe vendimeve të Këshillit Bashkisë • Të marrë masat e duhura, duke bashkëpunuar edhe me seksionin e shërbimeve publike me qëllim

		zbatimin e funksioneve të bashkisë.
--	--	-------------------------------------

Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

Qëllimi i programit 03140 është parandalimi i kundërvajtjeve administrative dhe konflikteve me qëllim sigurimin e rendit, qetësisë, mbarëvajtjes së punëve publike dhe zhvillimit normal të jetesës në komunitet.

Objektivi për këtë program është sigurimi i qetësisë, mbarëvajtjes së punëve publike dhe zhvillimi normal i jetesës në komunitet.

Realizimin e objektivit të programit 03140 e realizojnë produktet e aktivitetet ;

- Ngritja e procedurave të mirëfillta administrative për parandalimin e kundravajtjeve
- Mirëfunksionimi i sistemit të ofrimit të shërbimit nëpërmjet punësimit, zhvillimit dhe tajnimit të punonjësve.
- Funksionimi normal mjeteve në shërbim të policisë vendore.

Buxheti 2022 parashikon fond në vlerën 11 612 000 Lekë për programin 03140, ku 85% zënë pagat e personelit dhe 15% shpenzime operative.

Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike

BUXHETI 2022					
Raport		Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike			
Bashkia		GJIROKASTËR			
Programi		03140	Shërbimet e policisë vendore		
Shpenzimet e Programit (000 ALL)					
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2019	2020	2021	2022
		Fakt	Fakt	Buxh. Fillest.	Plani
Paga dhe Sigurime					
Paga	600	7,596.0	7,381.0	8,556.0	8,505.0
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	601	1,028.0	1,233.0	1,362.0	1,352.0
Korente					
Mallra dhe Shërbime	602	689.0	753.0	0.0	1,755.0
Subvencion	603	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta të Brendshme	604	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta të Jashtme	605	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta për Familje & Individë	606	0.0	0.0	0.0	0.0
Shpenzime Kapitale					
Aktive të Paprekshme	230	0.0	0.0	0.0	0.0
Aktive të Prekshme	231	0.0	0.0	0.0	0.0
TOTALI		9,313.0	9,367.0	9,918.0	11,612.0

Të Dhëna mbi Programin

Të Dhëna Bazë mbi Programin 03140						
	Të Përgjithshme	2017	2018	2019	2020	2021
Numri i punonjësve		15	15	15	16	16
Numëri i punonjësve me status		1	1	1	0	0
Raste të menaxhuara		120	112	102	480	400

Programi 03280**Përshkrim i Përgjithshëm i Programit**

Programi mbulon luftën kundër zjarrit, parandalimin e zjarrit dhe përballimin e emergjencave të tjera që vinë nga rreziqet natyrore ose aksidentet e trafikut rrugor.

Kodi i Programit**Emri i Programit****Përshkrimi i Programit**

03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	<ul style="list-style-type: none"> • Administrimi i parandalimit të zjarrit dhe problemeve të shërbimeve të mbrojtjes kundër zjarrit; • Funksionimi i njësive të zakonshme dhe njësive ndihmëse zjarrfikëse dhe i shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit të mbajtura nga autoritetet publike; • Funksionimi ose mbështetja e programeve trajnuese të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit. • Shërbimet e mbrojtjes civile, si shpëtimit malore, vrojtimi i plazheve, evakuimi i zonave të përmbytura etj.
-------	---	--

Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

Qëllimi i programit 03280 është gatishmëria e ngjarjeve të mbrojtjes nga zjarri, shembjet e ndërtesave, parandalimi dhe siguria. Të sigurojë shërbime emergjente të afta për t'iu përgjigjur në kohë dhe me sukses të gjitha emergjencave të zjarrit, shembjes së ndërtesës dhe shpëtimit të rrugës.

Një nga objektivat e programit 03280 është gatishmëria e ngjarjeve të zjarrit dhe të shembjeve të ndërtesave. Gatishmëria për t'iu përgjigjur në kohë të gjitha emergjencave të zjarrit dhe shembjes së ndërtesave gjatë vitit 2022 me një kohë reagimi mesatar prej 40 sekondash dhe kohë mesatare përgjigje/ndërhyrje prej 30 min në 2028.

Produktet për këtë objektiv janë;

- Gatishmëria për t'iu përgjigjur të gjitha shembjeve të mëdha dhe komplekse të ndërtesave dhe emergjencave nga zjarri gjatë vitit 2022 - Kategoria A (bazuar në një vlerësim të 100 thirrjeve gjatë 2022 dhe një kohe mesatare të përgjigjes prej 30 minutash).
- Gatishmëria për t'iu përgjigjur të gjitha shembjeve të vogla dhe jo-komplekse të ndërtesave dhe emergjencave të zjarrit gjatë gjithë vitit 2022 - (bazuar në një vlerësim të 25 thirrjeve gjatë 2022 dhe një kohe mesatare të përgjigjes prej 30 minutash)

Objektivi i dytë i programit 03280 është parandalimi i zjarrit / ngjarjet e sigurisë në ndërtesë. Rritja e aftësisë së sigurisë nga zjarri brenda biznesit dhe ambienteve shtëpiake dhe mes popullatës së përgjithshme përmes: 75% rritje në ambientet e biznesit dhe 35% rritje në ambiente shtëpiake të mbuluara me inspektime sigurie dhe alarme tymi.

Produktet për këtë objektiv janë;

- Inspektimet e sigurisë nga zjarri të ndërmarra, duke përfshirë montimin e alarmeve të tymit, në 200 lokale afariste në 2022.
- Inspektimet e sigurisë nga zjarri të ndërmarra, duke përfshirë montimin e alarmeve të tymit, në 300 ambiente shtëpiake në 2022.
- 80 ngjarje të edukimit publik për sigurinë nga zjarri / sigurinë e ndërtesave të ndërmarra në vitin 2022.

Objektivi i tretë është mirëmbajtja e pajisjeve të katër automjeteve të shërbimit zjarrfikës dhe pajisjet shoqëruese të mbajtura në gjendje të plotë pune dhe të afta të përdoren në përgjigje të menjëhershme ndaj zjarrit, shembjes së ndërtesës dhe emergjencave të shpëtimit të rrugës gjatë gjithë vitit 2022.

Produktet për këtë objektiv janë ;

- Shërbime operative të mirëmbajtjes së mjeteve të shërbimit zjarrfikës në gjendje të plotë pune gjatë gjithë vitit 2021 pasi i janë nënshtruar servisimit të planifikuar dhe riparimeve të rastit (siç kërkohet).
- Pajisjet e shërbimit të zjarrit në gjendje të plotë pune gjatë gjithë vitit 2022 pasi i janë nënshtruar servisimit të planifikuar dhe riparimeve të herëpashershme (siç kërkohet)

Një tjetër objektivi i programit 03280 është të sigurojë shërbime emergjente të afta për t'iu përgjigjur në kohë dhe me sukses të gjitha emergjencave të shpëtimit të rrugës.

Produktet për këtë objektivi janë;

- Gatishmëria për t'iu përgjigjur të gjitha emergjencave komplekse të rikuperimit në rrugë gjatë vitit 2022 - Ngjarje komplekse ku përfshihen 3 ose më shumë automjete me vlerësim për rrezikim jete.
- Gatishmëria për t'iu përgjigjur të gjitha emergjencave të shpëtimit të rrugës gjatë gjithë vitit 2022 - Njarje jo komplekse, me përfshirjen e një ose dy automjeteve.

Objektivi tjetër për programin 03280 është menaxhimi i personelit të shërbimit zjarrfikës në përpjesëtim me kërkesat për parandalimin e zjarrit dhe përgjigjen ndaj emergjencave në 2022. Si produkt për realizimin e këtij objektivi është rritja e kapaciteteve profesionale të 22 personave staf të shërbimit zjarrfikës të pajisur dhe të trajtuar në përputhje me kërkesat e Ligjit 152, gjatë gjithë vitit 2022.

Shpenzimet e programit sipas kategorive ekonomike

BUXHETI 2022					
Raport	Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike				
Bashkia	GJIROKASTËR				
Programi	03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile			
Shpenzimet e Programit (000 ALL)					
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2019	2020	2021	2022
		Fakt	Fakt	Buxh. Fillest.	Plani
Paga dhe Sigurime					
Paga	600	22,131.0	22,208.0	24,400.0	26,679.0
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	601	3,639.0	3,744.0	4,000.0	4,245.0
Korente					
Mallra dhe Shërbime	602	5,299.0	4,726.0	5,243.0	6,569.0
Subvencion	603	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta të Brendshme	604	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta të Jashtme	605	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta për Familje & Individë	606	0.0	305.0	0.0	0.0
Shpenzime Kapitale					
Aktive të Paprekshme	230	0.0	0.0	0.0	0.0
Aktive të Prekshme	231	0.0	0.0	0.0	700.0
TOTALI		31,069.0	30,983.0	33,643.0	38,193.0

Të Dhëna Bazë mbi Programin 03280

	Të Përgjithshme	2017	2018	2019	2020	2021
Numri i punonjesve		31	31	30	30	31
Numëri i punonjësve me status		30	30	30	30	30
Vatra zjarri		118	110	0	114	115
Ndërhyrje shpëtimi		112	80	0	175	170
Akt kontrolli		120	191	253	57	200
Rikontrolle		88	88	103	66	70
Akt teknik		8	8	14	14	14
Ripërtëritje akt teknik		30	29	26	6	15
Akt ekspertize		14	5	12	16	20
Miratim leje objekti		5	8	1	1	2
Alarm fals		0	1	0	0	0
Gjoha		0	0	6	4	0
Numri i thirrjeve		428	726	509	186	200

Për sa më lartë shihet se rritja e pagave vjen nga rritja e kapaciteteve të punonjësve zjarfikës dhe njëngritja e strukturës së sektorit të emergjencave civile. Buxheti 2022 për këtë program parashikon kryerjen e shpenzimeve kapitale të blerjes së një mjeti. Planifikimi është realizuar mbi të dhëna statistikore të zbatimit të buxhetit paraardhës.

Programi 04240

Përshkrim i Përgjithshëm i Programit

Mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm të prodhimit bujqësor, mbrojtja e konsumatorit, menaxhimi i ujitjes dhe kullimit.

Kodi i Programit	Emri i Programit	Përshkrimi i Programit
04240	Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit	<ul style="list-style-type: none"> Ndërtim ose organizim i sistemeve të kontrollit të përmbytjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit, duke përfshirë grante, hua dhe financime për punime të tilla; Administrim , shfrytëzim dhe mirëmbajtje e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit nën përgjegjësinë e njësisive të vetëqeverisjes vendore.

Shpenzimet e programit sipas kategorive ekonomike

BUXHETI 2022					
Raport		Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike			
Bashkia		GJIROKASTËR			
Programi		04240	Menaxhimi I infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit		
Shpenzimet e Programit (000 ALL)					
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2019	2020	2021	2022
		Fakt	Fakt	Buxh. Fillest.	Plani
Paga dhe Sigurime					
Paga	600	6,399.0	4,719.0	6,120.0	6,800.0
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	601	1,044.0	788.0	975.0	1,100.0
Korente					
Mallra dhe Shërbime	602	5,503.0	5,058.0	6,037.0	8,411.0
Subvencion	603	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta të Brendshme	604	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta të Jashtme	605	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta për Familje & Individë	606	0.0	55.0	0.0	0.0
Shpenzime Kapitale					
Aktive të Paprekshme	230	0.0	0.0	0.0	0.0
Aktive të Prekshme	231	0.0	0.0	26,822.0	7,529.0
TOTALI		12,946.0	10,620.0	39,954.0	23,840.0

Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

Qëllimi i programit 04240 është mbulimi me shërbime cilësore në bujqësi, ujitje - kullim dhe veterinari, në 70% të territorit të Bashkisë Gjirokaster në 92.4% të territorit deri në vitin 2026, duke mbështetur, përmirësuar dhe rritur aktivitetin e tyre, si me menaxhimi i situatës së përbytyjeve duke rritur kontrollet mbi kanalet kulluese.

Objektivi i parë I programit është vendosja në funksion dhe me efikasitet e rrjetit të kanaleve vaditëse dhe kulluese para fillimit të sezonit për gjashtë njësitë administrative. Produktet e objektivit të parë është mirëmbajtja rutinë e 10 Km lineare kanale ujitës dhe 7 Km lineare kanale kulluese në dy Njësitë Administrative Lunxhëri dhe Odrie. Mirëmbajtja rutinë e 12 Km lineare kanale ujitës dhe 7 Km lineare kanale kulluese në dy Njësitë Administrative Antigone dhe Lazarat. Mirëmbajtja rutinë e 14 Km lineare kanale ujitës dhe 7 Km lineare kanale kulluese në dy Njësitë Administrative Cepo dhe Picar.

Si një produkt tjetër i realizimit të objektivit të parë është edhe rehabilitimi i kanaleve ekzistuese ujitëse dhe kulluese por të papërdorura më parë në gjashtë njësitë administrative.

Përveç produkteve të lartpërmendura është edhe mirëmbajtja e kanaleve vaditëse dhe kulluese gjatë sezonit të verës dhe menaxhimi i qastrave të lëshimit të ujit. Ky produkt ka aktivitetet ;

- a) Vlerësimi i situatës dhe nevojave për mirëmbajtjen e qastrave të kanaleve për lëshimin e ujit.

- b) Rishikimi dhe përcaktimi i kalendarit të shpërndarjes së ujit.
- c) Mirëmbajtja e vogël e kanaleve vaditëse.
- d) Menaxhimi I lëshimit të ujit në ara sipas kalendarit të shpërndarjes.
- e) Shpërblimi i punonjësve mbështetës, manovrator.

Objekti i dytë i programit 04240 është edhe vendosja nën mbikëqyrje të plotë dhe ofrimi i standardeve bashkëkohore të veprimtarisë, në 80% të pikave të prodhimit dhe tregtimit të produkteve bujqësore dhe blektoriale në bashkinë Gjirokastrë, me 6 njësitë administrative brenda vitit 2022.

Produkti i objektivit është inspektimi dhe kontrolli i vazhdueshëm me çertifikim veterinar dhe agrokulturor në pikat e prodhimit dhe tregtimit të produkteve blektoriale dhe bujqësore në dy njësi administrative. Aktivitetet që rrjedhin nga produkti është hartimi i kalendarit për realizimin e inspektimeve, përgatitja e planeve të punës mbi inspektimin rutinë të subjekteve prodhuese dhe tregëtare, përgatitja e dokumentacionit për pajse me çertifikim veterinar dhe agrokulturor të subjekteve dhe realizimi i procedurës së inspektimit dhe pajisja me dokument veterinar dhe agrokultur. Si një nga programet më me pesh në drejtorinë e ujitjes dhe kullimit duke marrë në konsideratë emergjencat e përmbytjeve përveç administrimit dhe menaxhimit të kanaleve ujitëse dhe kulluese fondi në dispozicion për vitin 2022 parashikohet në shumën 23 840 000 Lekë.

Të Dhëna Bazë mbi Programin 04240						
	Të Përgjithshme	2017	2018	2019	2020	2021
Numri i punonjësve		10	10	10	10	10
Sipërfaqe tokë bujqësore		6793	6793	6793	6793	6793
Kanale vaditëse në km		137.6	137.6	137.6	137.6	137.6
Kanale kulluese në ha		3850	3850	3850	3850	3850
Pajisje me certifikata bujqësore		13250	14430	12340	13230	14000

Programi 04260

Përshkrim i Përgjithshëm i Programit		
Mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm të prodhimit bujqësor, mbrojtja e konsumatorit, menaxhimi i ujitjes dhe kullimit.		
Kodi i Programit	Emri i Programit	Përshkrimi i Programit
04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	<ul style="list-style-type: none"> • Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve pyjore; • Konservim, zgjerim dhe shfytëzim i racionalizuar i rezervave pyjore; • Mbikëqyrje dhe disiplinim i operacioneve pyjore dhe dhënie e licencave për prerje drurësh (hedhja e pemëve); • Organizim ose mbështetje për veprimtarinë ripyllëzuese, kontrollin e insekteve dhe sëmundjeve, shërbimet pyjore për luftën kundër zjarrit dhe për parandalimin e zjarrit dhe ofrimin e shërbimeve për operatorët pyjorë; • Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet pyjore; • Grante, hua ose or financime për të mbështetur veprimtaritë tregtare pyjore • Shpërndarja e kullotave, duke përfshirë menaxhimin e kullotjes • Administrim i çështjeve dhe shërbimeve të peshkimit dhe gjuetisë; mbrojtje, shtim dhe shfrytëzim racional të peshkut dhe kafshëve të egra; mbikëqyrje dhe disiplinim i peshkimit në ujëra të ëmbla, peshkimit bregdetar, kultivimit të peshkut, gjuetisë së kafshëve të egra dhe licencave të gjuetisë

Të Dhëna Bazë mbi Programin 04260

	Të Përgjithshme	2017	2018	2019	2020	2021
Numri i punonjësve		10	10	10	9	10
Sipërfaqe pyjesh		10170.83	10170.83	10170.83	10170.83	10170.83
Kullota		3850	3850	3850	3850	3850

Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

Qëllimi i programit 04260 është mirëmbajtja dhe përmirësimi i hapësirave të pyje-kullotave mbi 85% të sipërfaqes, rritja e kapaciteteve shfrytëzuese të sipërfaqes kullimore dhe pyjore mbi 75% të territorit të bashkisë brenda vitit 2025.

Objektivi i programit për vitin 2022 është mirëmbajtja, përmirësimi, rritja e sipërfaqes kullimore, shfrytëzimi i sipërfaqes mbi 70% të territorit në administrim të bashkisë.

Inspektimi i të gjitha hapësirave kullimore duke marrë parasysh hapësirat e shfrytëzuara dhe ato të pashfrytëzueshme.

Shfrytëzimi i hapësirave kullimore gjatë sezonit dimëror dhe veror në katër njësi administrative, lidhja e kontratave me blegtorët.

Shfrytëzimi i hapësirave kullimore gjatë sezonit dimëror dhe veror në katër njësi administrative, lidhja e kontratave me blegtorët.

Rehabilitimi i lervave nëpër hapësirat kullimore në të gjashta njësitë administrative.

Rehabilitimi i pahësirave të reja kullimore, të pashfrytëzuar më parë.

Mirëmbajtja, përmirësimi, rritja e sipërfaqes pyjore mbi 70% të territorit në administrim të bashkisë dhe shfrytëzimi mbi 60% të sipërfaqes.

Përgatitja e planit të punës për lëvizje të programuar në terren.

Monitorim dhe vlerësim i situatës mbi gjendjen e hapësirave pyjore.

Monitorim dhe mbikëqyrje e hapësirave pyjore në shfrytëzim.

Monitorim dhe vlerësim i situatës mbi gjendjen pyjeve.

Një nga objektivat e programit 04260 është sigurimi i mirëfunksionimit të sistemit të ofrimit të shërbimit nëpërmjet punësimin, zhvillimit dhe tajnimit të administratës menaxheriale dhe teknike. Aktivitetet kryesore për realizimin e objektivit të sigurimit të mirëfunksionimit të sistemit të ofrimit të shërbimit janë shpenzimet për shpërblim page të stafit menaxherial, shpenzime operative për funksionimin administrativ të funksionit dhe kryerja e detyrave funksionale të stafit teknik.

Shpenzimet e programit sipas kategorive ekonomike

BUXHETI 2022					
Raport	Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike				
Bashkia	GJIROKASTËR				
Programi	04260	Administrimi I pyjeve dhe kullotave			
Shpenzimet e Programit (000 ALL)					
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2019	2020	2021	2022
		Fakt	Fakt	Buxh. Fillest.	Plani
Paga dhe Sigurime					
Paga	600	6,148.0	6,074.0	6,218.0	6,250.0
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	601	1,063.0	1,015.0	990.0	1,000.0
Korente					
Mallra dhe Shërbime	602	225.0	781.0	800.0	300.0
Subvencion	603	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta të Brendshme	604	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta të Jashtme	605	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta për Familje & Individë	606	0.0	128.0	0.0	0.0
Shpenzime Kapitale					
Aktive të Paprekshme	230	0.0	0.0	0.0	0.0
Aktive të Prekshme	231	2,308.0	2,225.0	0.0	0.0
TOTALI		9,744.0	10,223.0	8,008.0	7,550.0

Programi 04250**Përshkrim i Përgjithshëm i Programit**

Programi mbulon lëvizshmërinë vendore të sigurtë dhe të rrjedhshme rrugore për të gjitha kategoritë e përdoruesve privatë të rrugëve dhe për transportin publik.

Kodi i Programit	Emri i Programit	Përshkrimi i Programit
04250	Rrjeti rrugor	<ul style="list-style-type: none"> Funksionimi, përdorimi, ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit (rrugë, ura, tunele, parkime, terminale autobusësh, rrugë këmbësore dhe korsi biçikletash etj.); Studime për rehabilitimin, përmirësimin, ndërtime të reja në sistemet e transportit për rrjetin rrugor nën administrimin e njësisë vendore.

		<ul style="list-style-type: none"> • Marrja e masave për lehtësimin e trafikut dhe kontrollin e sistemit rrugor rural të njësisë vendore.
--	--	--

Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

Qëllimi i programit 04520 është mirëmbajtje dhe përmirësim i infrastrukturës rrugore rurale në 95.4 % deri në vitin 2025, rritja e cilësisë së lëvizshmërisë rurale, lidhjes së rrugëve dytësore rurale me ato kryesore dhe nacionale, dhe ndërtime të reja në sistemet e transportit për rrjetin rrugor.

Objektivi kryesor është rritja e aksesueshmërisë së rrjetit rrugor rural nëpërmjet mirëmbajtjes dhe rehabilitimit infrastrukturor. Një nga produktet e objektivit të lartpërmendur është mirëmbajtja rutinë e 248 Km infrastrukturës rrugore rurale. Aktivitetet që rredhin nga produkti janë mbikëqyrja dhe vlerësimi i gjendjes së infrastrukturës rrugore, hartimi i planeve për ndërhyrje në mirëmbajtjen e rrugëve, hartimi i procedurave të prokurimit të sigurimit të bazës materiale për të cilën buxheti 2022 parashikon investim capital në shumën 14 000 000 lekë. Për vitin 2022 është planifikuar që mirëmbajtja e rrugëve të realizohet në zonat si më poshtë:
Njësia Administrative Picar

- Fshati Picar
- Fshati Shtëpëz
- Fshati Kolonjë

Në këto fshatra do të punohet nëpër lagje si dhe në qendrat e fshatrave duke sistemuar rrugë të brendshme.

Njësia Administrative Cepo

- Fshati Mashkullorë
- Fshati Taroninë
- Fshati Plesat
- Fshati Zhulat
- Fshati Kardhiq
- Fshati Prongji

Në këto fshatra do të punohet nëpër lagje si dhe në qendrat e fshatrave duke sistemuar rrugë të brendshme.

Njësia Administrative Odrie

- Fshati Labovë e vogël

- Fshati Tërbuq
- Fshati Hundkuq

Në këto fshatra do të punohet nëpër lagje si dhe në qendrat e fshatrave duke sistemuar rrugë të brendshme.

Njësia Administrative Lunxhëri

- Fshati Këllëz
- Fshati Valare (Lagjia Stalla)
- Fshati Gjat

Në këto fshatra do të punohet nëpër lagje si dhe në qendrat e fshatrave duke sistemuar rrugë të brendshme.

Njësia Administrative Lunxhëri

- Fshati Këllëz
- Fshati Valare (Lagjia Stalla)
- Fshati Gjat

Në këto fshatra do të punohet nëpër lagje si dhe në qendrat e fshatrave duke sistemuar rrugë të brendshme.

Njësia Administrative Antigone

- Fshati Arshi Lengo(Lagjia e Re)
- Fshati Asim Zeneli
- Fshati Saraqinishtë

Në këto fshatra do të punohet nëpër lagje si dhe në qendrat e fshatrave duke sistemuar rrugë të brendshme.

Njësia Administrative Lazarat

Në këtë fshat do të bëhen sistemime në çdo lagje duke hedhur 160 m³ beton .

Në lagjet e qytetit

Për qytetin është planifikuar të hidhet rreth 580 m³ beton dhe konkretisht :

- Lagjia Zinxhira ,në këtë lagje janë disa segmente të vogla rrugore por vëmendja më e madhe për këtë vit do t'i kushtohet “Zonës së Golëmasve” .
- Lagjia “SMT”
- Lagjia “Grëhot”
- Lagjia “Cfakë”
- Lagjia “Dunavat” ,është për të punuar në disa rrugica të kësaj lagjeje.
- Lagjia Granica.

Një objektiv tjetër i programit 04520 është rehabilitimi i infrastrukturës rrugore rurale dhe lidhja e rrugëve dytësore me ato kryesore dhe nacionale. Produkti i objektivit të lartpërmendur është pajisja e infrastrukturës rrugore rurale me sinjalistikë horizontale dhe vertikale. Aktivitet

e realizimit të produktit për pajisjen me sinjalistikë është studimi dhe hartimi i planit të ndërhyrjes për përmirësimin e sinjalistikës rrugore.

Për ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore nevojitet menaxhimi dhe rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore. Planifikimi në buxetin 2022 për shpenzimet operative paga dhe sigurime parashikohet në vlerën 40 799 000Lekë

Të Dhëna Bazë mbi Programin 04520						
	Të Përgjithshme	2017	2018	2019	2020	2021
Numri i punonjësve		10	10	10	10	10
Numër stolash për pushuesit (ose infrastrukturë e ngjashme) të mirëmbajtur		50	80	80	68	90
Sipërfaqe të shesheve të mirëmbajtura		7800	7000	6350	5450	7500
Ura të mirëmbajtura		20	20	20	20	20
Sipërfaqe trotuaresh të mirëmbajtura		34340	34340	30000	21900	36000

Shpenzimet e programit sipas kategorive ekonomike

BUXHETI 2022					
Raport	Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike				
Bashkia	GJIROKASTËR				
Programi	04520	Rrjeti rrugor rural			
Shpenzimet e Programit (000 ALL)					
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2019	2020	2021	2022
		Fakt	Fakt	Buxh. Fillest.	Plani
Paga dhe Sigurime					
Paga	600	21,209.0	4,324.0	5,417.0	5,000.0
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	601	3,769.0	825.0	720.0	900.0
Korente					
Mallra dhe Shërbime	602	6,940.0	7,383.0	9,000.0	0.0
Subvencion	603	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta të Brendshme	604	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta të Jashtme	605	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta për Familje & Individë	606	0.0	32.0	0.0	0.0
Shpenzime Kapitale					
Aktive të Paprekshme	230	0.0	0.0	0.0	0.0
Aktive të Prekshme	231	2,500.0	3,156.0	5,656.0	34,899.0
TOTALI		34,418.0	15,720.0	20,793.0	40,799.0

Programi 047**Përshkrim i Përgjithshëm i Programit**

Nxitja e projekteve zhvëllimore që kanë për qëllim rritjen ekonomike të turizmit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, si dhe zhvillimi dhe promovimi i turizmit.

Kodi i Programit	Emri i Programit	Përshkrimi i Programit
04760	Zhvillimi i turizmit	<ul style="list-style-type: none"> • Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve të turizmit vendor; promovim dhe zhvillim i turizmit vendor. • Funksionimi i zyrave turistike vendore etj.; organizim i fushatave publicitare, duke përfshirë prodhimin dhe shpërndarjen e literaurës promovuese e të një natyre të ngjashme; • Mbledhje dhe botim i statistikave vendore për turizmin. • Realizimi i përmirësimeve pamore në hapësirat urbane të bashkisë, përmes mbjelljes së luleve, shkurreve dhe pemëve dekorative, zëvendësimi i trotuareve të prishura me material natyrore dhe instalimi drita rrugësh të stilit historik etj.

Programi 04760 administrohet nga Drejtoria e Turizmit, Trashëgimisë dhe Sporteve e cila është e përbërë nga katër sektorë ;

1. Sektori i Turizmit dhe promovimit
2. Sektori i Trashëgimisë dhe aktiviteteve kulturore
3. Sektori i Sportit
4. Sektori i Shërbimeve mbështetëse operacionale

Në kuadrin e saj administrativ funksional kjo Drejtoria ka për detyrë të zhvillojë dhe të përpilojë politika promovimi, të promovojë Gjirokastrën si destinacion turistik tërheqës për vizitorë vendas e të huaj, duke mbështetur zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm.

1.Sektori i turizmit dhe promovimit është sektori që do të ndjekë sistematikisht grafikun e fluksit turistik, ndaj do të krijojme në funksion të saj formatin e caktuar për të patur një pamje sa më të qartë mbi karakteristikat e turistëve që vizitojnë qytetin.

Do të krijojme databazën e biznesit aktiv turistik si dhe do të ndërtojë gradualisht strategjinë lokale të turizmit duke mbledhur të dhëna të vazhdueshme fushën e turizmit. Do të bëjë promovimin e qytetit dhe zonës rurale në të gjitha rrjetet sociale dhe të dhënat statistikore

mujore do të përmbliidhen në një relacion përkatës mbi nevojshmëritë që kontigjenti i turistëve vizitorë ka shfaqur.

Përgatitja e materialeve promovuese të monumenteve të kulturës, siteve arkeologjike, monumnteve natyrore etj, përbëjnë oferta interesante turistike për vizitorët.

Për të patur një mirëfunksionim të të gjithë sektorëve si dhe një bashkërendim të punës midis tyre është i nevojshëm parashikimi dhe miratimi i kërkesave dhe prozimeve bashkangjitur.

Krijimin e databazës së bizneseve turistike operationale të çertifikuara të tipologjisë struktura akomoduese, dyqane souvenir dhe tour operator që funksionojnë në territorin e Bashkisë Gjirokastër dhe azhurnimin sistematik të kësaj databaze si element shumë i rëndësishëm i kategorizimit dhe mbajtjes së të dhënave për zhvillimin e industriës turistike në zonë.

Menaxhimi i zyrës së informacionit turistik duke ofruar informacion të detajuar dhe përshkrues të siteve dhe atraksioneve turistike të territorit të bashkisë kundrejt vizitorëve të huaj dhe vendas që aksesojnë këtë zyrë si dhe disenjimi i materialeve orientuese dhe hartave për logjistikë mbështesë kundrejt itinerareve të turistëve.

2. Sektori i trashëgimisë dhe aktiviteteve zë një peshë të rëndësishme në realizimin e objektivave kryesore të Drejtorisë që janë gjallërimi i jetës kulturore dhe artistike të Qytetit, përgatitja e një kalendari aktiviteteve që të jenë në vetvete një oferte turistike tërheqese për vizitorë shqiptarë dhe të huaj, nxitja e aktivitetit ekonomik të biznesit të vogël që kryesisht varet nga turizmi dhe turistët si dhe ruajtja e traditës, kulturës dhe gjetja e mënyrave efikase që ajo të jetë lehtësisht e kuptueshme për brezin e ri. Nevoja për organizimin e aktiviteteve që kujtojnë e theksojnë ngjarje e momente të rëndësishme të jetës historike e kulurore të qytetit ndër vite, përkujtimi i personaliteteve të jetës artistike e politike të qytetit e vendit, pjesë e historisë sonë të përbashkët kombëtare, janë një pjesë e rëndësishme e aktiviteteve të këtij sektori. Është menduar dhe parashikuar gjithashtu edhe krijimi i produkteve përfaqësuese të qytetit të cilat të

jenë pjesë e një shporte turistike mirëprezantuese të qytetit dhe atraksioneve kryesore të tij si dhe të intenerareve kryesore.

Një pjesë po kaq të rëndësishme e zënë edhe bashkëpunimet me aktorë të tjerë si OJF apo individë për realizimin e aktiviteteve të ndryshme të cilat organizohen për gjatë gjithë vitit dhe në fusha të ndryshme artistike.

Ndërtimin e partneriteteve me institucione qëndrore dhe lokale por edhe organizata të shoqërisë civile në zhvillimin e brandeve dhe veprimtarive të institucionalizuara në funksion të krijimit të produkteve lokale autentike si në nivel material ashtu dhe jo material.

3. Sektori i sportit.

Fokusi për gjatë këtij viti do të jetë në organizimin e aktiviteteve masive në minifutboll, basketboll e shah, në bashkëpunim me shkollat 9-vjecare e të mesme të Bashkisë Gjirokastër si dhe me organizime të tjera e grupime sipas mundësive.

Federimi i ekipit të shahut në FSHSH, për grupmoshat e rritura është një ndër qëllimet e këtij sektori. Organizimi dhe funksionimi i rregullt i një ekipi basketbolli për djem dhe për vajza si dhe federimi i tyre në FSHB do të jetë një përpjekje e këtij sektori përgjat vitit 2022.

Nevoja e specialistëve të jashtëm për realizimin e aktiviteteve sportive kryesisht aktiviteteve që kanë si bazë fillim e tyre nëpër institucionet arsimore të bashkisë Gjirokastër.

4 Sektori i shërbimeve mbështetëse operationale.

Pjesë mëse e rëndësishme e organizimit dhe mirëfunksioimit të cdo aktiviteti në Drejtorisë si dhe një suport thelbësor në cilësinë e aktiviteteve.

Është menduar blerja e bazës materiale për strukturën me lënde druri të një skene të lëvizeshme duke evituar përdorimin e buxhetit tonë në marrjen me qera të këtij shërbimi.

Skena do të strukturohet nga vetë punonjësit e sektorit.

Aktivitetet e parashikuara.

Objektivat kryesore.

1. Krijimi i një oferte turistike kulturore gjithëvjeto.
2. Identifikimin dhe trajtimin e problematikave që mund të shfaqen në çështjet e turizmit si gjatë sezonit dhe jashtë tij.
3. Përpjekje për vendosjen e piketave kryesore të strategjisë lokale të turizmit në koherencë të plotë me strategjinë kombëtare.
4. Risjelljen në vëmendje të ngjarjeve historike e kulturore kryesore të zhvillimit të qytetit duke punuar fort në mbledhjen e të dhënave e fakteve historike në bashkëpunim me qytetarë e institucione kompetente.
5. Vëmendje në mirëmenaxhimin e mirëfunksionimin e muzeve:
 - a) muzeu i armeve (Kala)
 - b) muzeu Gjirokastra(Kala)
 - c) muzeu etnografik
 - d) Banesa Kadare

e) Tuneli i Luftës së Ftohtë

Duke pasur përgjegjshmërinë e ruajtjes së aseteve plot vlerë që secili prej tyre përmban si dhe pasurimin e tyre me të tjera elemente origjinale, me vlerë për cilësinë e ofruar ndaj vizitorëve. 6. Bashkëpunim i fortë e efikas me organizma publike e OJF për të patur diversitet e cilësi në të njëjtën kohë.

Vënia në dispozicion i të gjitha kapaciteteve njerëzore, kryesisht në ideimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me trashëgiminë dhe ngjarjet historike kryesore të qytetit e vendit.

Duke parë bashkëpunimet e suksesshme të ndodhura në vitet pararendëse do të vazhdojmë edhe këtë vit të forcojmë bashkëpunimin me TID Gjirokastrë dhe AADF si dhe me bashkëpunëtorë të tjerë. Nëpërmjet këtyre bashkëpunimeve synojmë ofrimin e një pakete shumë të vlerësueshme të aktiviteteve kulturore artistike si dhe sjelljen e traditës dhe trashëgimisë aty ku gjithmonë e meriton të jetë.

Diversiteti i aktiviteteve përfshin këtë vit edhe klasiken nëpërmjet katër shfaqeve muzikore përgjatë vitit duke sjellë për turistë e publikun lokal një kompleks eventesh gjatë të cilëve synohet edhe përfshirja e promovimi i elementëve të rinj jo vetëm të qytetit por edhe më gjerë. Një vëmendje e shtuar këtë vit ju është dhënë edhe mbështetjes së aktiviteteve në cdo njësi administrative. Aktivitete të cilat promovojnë produktet artizanale, bujqësore etj, të zonës nëpërmjet panairëve të menduara për t'u organizuar në cdo njësi. Gjithashtu dhe organizimin e festave kryesore vjetore në qendrat e njësive administrative duke promovuar asetet kulturore e të trashëgimisë që këto zona mbartin.

Njësia e koordinimit dhe Integritimit European në propozimet e paraqitura pranë drejtorisë sonë, ka vendosur theksin në organizimin e aktiviteteve që fokusohen në ditët ndërkombëtare dhe nismave të mara nga gjithë organizmat ndërkombëtare duke na bërë pjesë e zhvillimit të aktiviteteve në mbarë botën.

Duke parë e vlerësuar si të suksesshme disa prej aktiviteteve të organizuara në dy vitet e fundit gjatë të cilave qyteti është vizituar maksimalisht nga turist vendas e të huaj, është menduar që edhe këtë vit të sjellim në bashkëpunim me të tretë evente të jashtëzakonshme sic janë “Retro n’sokak” e “Gjirokastra mirëpret”.

Programi 04760 është një program i ri i krijuar gjatë vitit 2021, dhe si program i ri krahasimi i angazhimeve financiare me vitet paraardhëse është i pamundur. Buxheti 2022 si buxhet fillestar për këtë program ka parashikuar fond limit në shumën 22 212 000 Lekë nga të cilat 16 100 000 Lekë shkojnë për shpenzime operative paga dhe sigurime dhe 6 112 000 Lekë për aktivitete dhe shpenzime kapitale për ngritjen e lapidarit “Lufta e Qestoratis”.

Programi 06260

Përshkrim i Përgjithshëm i Programit

Programi mbulon veprimtari për zhvillimin dhe përmirësimin e kontekstit të jetesës.

Kodi i Programit	Emri i Programit	Përshkrimi i Programit
------------------	------------------	------------------------

06260	Shërbimet publike vendore	<ul style="list-style-type: none"> • Planifikim i përmirësimit dhe zhvillimit të strukturave të tilla si shërbimet për publikun, shëndeti, arsimit, kultura, rekreacioni etj. për komunitetet • Mbjellja e luleve, shkureve dhe pemëve dekorative, të cilat përmirësojnë hapësirën e gjelbërt të njësisë së vetëqeverisjes vendore. • Zvendësimi i trotuareve të prishura me material cilësorë që përmirëson hapësirën publike dhe rrit cilësinë e shërbimit ndaj qytetarve. • Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e varrezave publike, si dhe garantim I shërbimit public të varrimit. • Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbërta. • Të gjitha shërbimet e tjera publike sipas specifikimeve të cdo njësie të vetëqeverisjes vendore.
-------	---------------------------	--

Qëllimi i programit 06260 është sigurimi i pastrimit të hapësirave publike, trajtimi i mbetjeve urbane dhe shërbimet e varrimit për të gjithë qytetarët në Bashki.

Objektivat për këtë program janë;

1. Mbledhja dhe asgjësimi i mbetjeve nga 85% e familjeve dhe 70% e bizneseve për vitin 2022.
2. Mbetje të ngurta të mbledhura nga lagjet e sipërme të qytetit.
3. Mbetje të ngurta të mbledhura në 6 njësi administrative.
4. Rrugë urbane të fshira dhe të lara.
5. Sigurimi i shërbimeve funerale për të gjithë qytetarët në Bashki duke ruajtur zonën aktuale të varrezave të qytetit dhe duke u zgjeruar me 10% deri në 2023.
6. Varreza të mirëmbajtura.
7. Sigurimi për mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e të gjitha zonave aktuale të gjelbërta dhe miniparqeve, ndërsa zgjerimi i 25% të zonave të gjelbërta deri në 2026.
8. Sigurimi i mirëmbajtjes dhe rehabilitimit të të gjitha zonave aktuale të gjelbërta dhe miniparqeve, ndërsa zgjerimi i zonave të gjelbra me 5% në 2023.
9. Sipërfaqe të gjelbra aktuale të mirëmbajtura.
10. Sipërfaqe të gjelbra aktuale të rehabilituara.
11. Sipërfaqe të gjelbra të reja të krijuara në qytet.
12. Mini parqe të mirëmbajtura.
13. Rikonstruksioni i kendeve të lojrave për fëmijë në mini parqet e qytetit.
14. Sigurimi i një mbulimi efikas të energjisë për ndriçimin publik për 80% të territorit të Bashkisë deri në 2026.
15. Sigurimi i ndriçimit publik me efikasitet të energjisë për 80% të qytetit dhe 30% të të gjitha njësive administrative në 2022.
16. Rrugë të ndriçuara.

17. Rrjet i ri i ndriçimi.
18. Ofrimi i Shërbimeve Publike përmes punësimit, trajnimit dhe zhvillimit të 174 anëtarëve të stafit dhe 5 personelit menaxherial.
19. Ofrimi i shërbimeve publike përmes punësimit, trajnimit dhe zhvillimit të 174 anëtarëve të stafit dhe 5 personelit menaxherial në 2022.

Mirëmbajtja e ndricimit publik për vitin 2022 parashikohet të ndërhyhet si më poshtë:

Sistemime dhe ndërhyrje në rrjet në lagjen Dunavat I dhe II. Për shkak të rrjetit të amortizuar është planifikuar zvendësimi i këtij rrjeti me tel Alumini të veshur Ø 16 si dhe vendosja e aksesorëve ,Tirantuseve dhe Konjektoreve.

Sistemime dhe ndërhyrje në rrjet në lagjen Manalat I dhe II. Për shkak të rrjetit të amortizuar është planifikuar zvendësimi i këtij rrjeti me tel Alumini të veshur Ø 16 si dhe vendosja e aksesorëve ,Tirantuseve dhe Konjektoreve.

Sistemime dhe ndërhyrje në rrjet në lagjen “Cfakë”. Për shkak të rrjetit të amortizuar është planifikuar zvendësimi i këtij rrjeti me tel Alumini të veshur Ø 16 si dhe vendosja e aksesorëve ,Tirantuseve dhe Konjektoreve.

Gjithashtu është planifikuar shtrim i një linjë të re në Lagjen “Zinxhira” konkretisht në rrugën “Baba Selimi”. Gjithashtu linjë e re do të shtrohet në lagjen SMT . Për çdo lagje të është planifikuar ndërhyrje në ndriçues duke bërë zvendësimin e ndriçuesave të amortizuar.

Njësitë Administrative.

Për vitin 2022 është planifikuar të bëhet ndërhyrje në rrjet konkretisht :

Fshati Golem : Shtrirje linje të re si me tel Alumini të veshur Ø 16 si dhe vendosja e aksesorëve.Fshati Kolonjë : Shtrirje linje të re me tel Alumini të veshur Ø 16 si dhe vendosja e aksesorëve. Fshati Humelicë : Shtrirje linje të re me tel Alumini të veshur Ø 16 si dhe vendosja e aksesorëve.Fshati Taroninë : Shtrirje linje të re me tel Alumini të veshur Ø 16 si dhe vendosja e aksesorëve. Fshati Plesat :Shtrirje linje te re me tel Alumini te veshur Ø 16 i veshur si dhe vendosja e aksesorëve .

Trajtimi i mbetjeve të ngurta brenda standardeve kërkon një angazhim të madh të fondeve buxhetore. Kostot e larta përkojnë me rritjen e karburantit në dyfishin e tij, planifikimin e blerjeve të tre mjeteve të tera me të ardhurat e veta dhe një mjet të ri të financuar nga Abasada Japoneze. Po në këtë kuadër janë planifikuar 120 kontinier të financuar nga të ardhurat e veta dhe 27 të tillë të financuar nga Ambasada Japoneze. Buxheti 2022 angazhon fond buxhtor në favor të trajtimit të mbetjeve 20 000 000 Lekë .

Shpenzimet e programit sipas kategorive ekonomike

BUXHETI 2022					
Raport	Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike				
Bashkia	GJIROKASTËR				
Programi	06260	Shërbimet publike vendore			
Shpenzimet e Programit (000 ALL)					
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2019	2020	2021	2022
		Fakt	Fakt	Buxh. Fillest.	Plani
Paga dhe Sigurime					
Paga	600	55,271.0	70,429.0	79,541.0	80,446.0
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	601	9,002.0	11,659.0	12,612.0	17,400.0
Korente					
Mallra dhe Shërbime	602	41,126.0	33,141.0	35,179.0	42,411.0
Subvencion	603	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta të Brendshme	604	0.0	0.0	993.0	0.0
Transferta të Jashtme	605	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta për Familje & Individë	606	364.0	529.0	0.0	0.0
Shpenzime Kapitale					
Aktive të Paprekshme	230	0.0	564.0	0.0	0.0
Aktive të Prekshme	231	17,350.0	60,807.0	147,727.0	234,560.0
TOTALI		123,113.0	177,129.0	276,052.0	374,817.0

Të Dhëna Bazë mbi Programin 06260

	Të Përgjithshme	2017	2018	2019	2020	2021
Numri i punonjesve		183	183	183	181	181
Km rrugë urbane të mirëmbajtura		634	634	650	720	800
km ndricim rrugor të mirëmbajtura		193	200	159	200	340
Numër pemësh të mbjella		760	850	812	250	750
Rrjet egzistues të ndricimit në mirëmbajtur në ha		140	135	142	165	200

Programi 08130

Përshkrim i Përgjithshëm i Programit		
Programi mbulon operimin ose mbështetjen e strukturave për aktivitete çlodhëse dhe sportive dhe kontribut financiar për promovimin e sporteve.		
Kodi i Programit	Emri i Programit	Përshkrimi i Programit
08130	Sport dhe argëtim	<ul style="list-style-type: none"> • Vënie në funksionim ose mbështetje e strukturave për veprimtari ose ngjarje sportive aktive (fusha lojërash, fusha tenisi, pishina noti, fusha skuoshi, korsi vrapimi, terrene golfi, ringje boksi, pista patinazhi, palestra etj.); mbështetje për ekipet përfaqësuese vendore në veprimtaritë sportive • Vënie në funksionim ose mbështetje e strukturave për veprimtari ose ngjarje sportive pasive (struktura për qëndrimin e spektatorëve; sidomos vende të pajisura për lojëra me letra, lojëra me taberlë etj.)

BUXHETI 2022					
Raport	Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike				
Bashkia	GJIROKASTËR				
Programi	08130	Sport dhe Argëtim			
Shpenzimet e Programit (000 ALL)					
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2019	2020	2021	2022
		Fakt	Fakt	Buxh. Fillest.	Plani
Paga dhe Sigurime					
Paga	600	3,910.0	3,354.0	3,451.0	3,000.0
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	601	618.0	554.0	550.0	500.0
Korente					
Mallra dhe Shërbime	602	11.0	50.0	70.0	110.0
Subvencion	603	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta të Brendshme	604	0.0	0.0	0.0	15,000.0
Transferta të Jashtme	605	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta për Familje & Individë	606	0.0	93.0	0.0	0.0
Shpenzime Kapitale					
Aktive të Paprekshme	230	0.0	0.0	0.0	0.0
Aktive të Prekshme	231	0.0	0.0	0.0	113.0
TOTALI		4,539.0	4,051.0	4,071.0	18,723.0

Programi 08220

Përshkrim i Përgjithshëm i Programit		
Programi mbulon operimin ose mbështetjen e strukturave për aktivitete çlodhëse dhe sportive dhe kontribut financiar për promovimin e sporteve.		
Kodi i Programit	Emri i Programit	Përshkrimi i Programit
08220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillim, mbrojtje dhe promovim i vlerave të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrim i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve. • Zhvillim, mbrojtje dhe promovim i bibliotekave, dhe ambienteve për lexim me qëllim edukimin e përgjithshëm qytetar. • Mbështetje për muzeumet, galeritë e arteve, teatrot, sallat e ekspozitave • Organizim ose mbështetje për ngjarjet kulturore(koncerte, prodhime skenike dhe filma, shfaqje artistike) •

Shpenzimet e programit sipas kategorive ekonomike

BUXHETI 2022					
Raport	Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike				
Bashkia	GJIROKASTËR				
Programi	08220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore			
Shpenzimet e Programit (000 ALL)					
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2019	2020	2021	2022
		Fakt	Fakt	Buxh. Fillest.	Plani
Paga dhe Sigurime					
Paga	600	25,365.0	19,992.0	20,469.0	15,000.0
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	601	4,543.0	3,333.0	3,257.0	2,500.0
Korente					
Mallra dhe Shërbime	602	11,623.0	2,752.0	11,518.0	8,266.0
Subvencion	603	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta të Brendshme	604	0.0	500.0	0.0	0.0
Transferta të Jashtme	605	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta për Familje & Individë	606	95.0	163.0	0.0	0.0
Shpenzime Kapitale					
Aktive të Paprekshme	230	0.0	0.0	0.0	0.0
Aktive të Prekshme	231	0.0	0.0	67,165.0	14,050.0
TOTALI		41,626.0	26,740.0	102,409.0	39,816.0

Qëllimi i programit 08220 është edukimi i shoqërisë me vlera kombëtare, kulturore dhe artistike nëpërmjet rritjes së numrit dhe cilësisë së aktiviteteve kulturore-artistike.

Produktet dhe aktivitetet për vitin 2022 në këtë program janë;

1. Përgatitja e një premiere me autorë të huaj dhe dy premiera me autorë shqiptar. Subjekti për premierë për fëmijë për vitin 2022 do të jetë me autorë të huaj.
 - 1.1 Ngritja e urdhërtit mbi komisionin e evidentimit dhe vlerësimit artistik të veprave.
 - 1.2 Përgatitja e premierave kërkon angazhimin e stafit të jashtëm si autorë, kompozitor , koreograf dhe skenograf. Trupa e aktorëve do të jetë stafi i brendshëm.
 - 1.3 Realizimi i procedurave të prokurimit për sigurimin e bazës materiale të garderobës dhe ngritjen e skenës.
 - 1.4 Akomodimi i stafit të jashtëm që është ngarkuar për përgatitjen e premierave.
 - 1.5 Krijimi i imazheve specifike për cdo premierë dhe paraqitjen e tyre pranë komisionit të vlerësimit.

- 1.6 Realizimi i procedurave të prokurimit për hartimin e kancelarive të promocionit si postera, banera, fletëpalosje dhe ftesa.
2. Rritja e numrit të shfaqjeve nga 8 të planifikuar për vitin 2021 në 10 për vitin 2022 dhe promovimin e shfaqjeve më të mira në 4 teatre brenda vendit dhe në dy të tilla jashtë vendit.
- 2.1 Sigurimi i gjithë bazës materiale për akomodimin e trupës së teatrit që do të bëjë promovimin e veprës së vlerësuar.
- 2.2 Blerja e një automjeti që do të realizojë lëvizjen e trupave teatrore por edhe të bazës materiale për dhënien e shfaqjeve jashtë ambienteve të teatrit të qytetit.
- 2.3 Realizimi i festivalit ndërteator , pjesëmarrja e trupave teatrore nga teatrot brenda vendit dhe trevat.
- 2.4 Sigurimi i gjithë infrastrukturës për akomodimin e trupave të teatrove pjesëmarrëse në festival.
- 2.5 Pjesëmarrja e figurave do të jetë prezente gjatë gjithë netëve të festivalit.
- 2.6 Realizimi i procedurave të prokurimit për krijimin e bazës materiale që do të shpërndahet për vlerësime me cmime te trupave.
3. Për përgatitjen e shfaqjeve me pjesëmarrje të nxënësve të arsimit parashkollor do të angazhohet ekipi krijues, dhe sigurimi bazës materiale kancelarie.
- 3.1 Procedura e prokurimit për sigurimin e bazës materiale për shfaqjet.
- 3.2 Shfaqje artistike social -kulturore me tematika të ndryshme, minimumi 5 shfaqje gjatë vitit 2022.
- 3.3 Realizimi i pagesave për përfshirjen e studentëve dhe nxënësve.
- 3.4 Procedura e prokurimit për sigurimin e bazës materiale për shfaqjet.

Të Dhëna Bazë mbi Programin 08220

	Të Përgjithshme	2017	2018	2019	2020	2021
Numri i punonjesve		50	50	50	47	47
Shfaqje premierw		5	4	5	0	4
Lexues mesatar nw bibliotekw		250	290	245	245	245
Shfaqje teatrore		15	35	15	5	30

Programi 08220 administron gjithashtu edhe dy projekte pryesore me financim nga BE, të cilat konsistojnë;

“ADRISEISMIC”

Zona Adriatiko-Joniane është shumë e dëmtuar nga tërmetet. Secili vend ka zhvilluar ligje dhe norma, metoda, teknika dhe ekspertizë për të trajtuar rreziqet e tërmetit dhe për të zvogëluar cenueshmërinë sizmike të mjedisit të ndërtuar. Sidoqoftë, në zonat urbane dhe veçanërisht në qendrat historike ato mbeten të larta.

Objektivi i përgjithshëm i ADRISEISMIC është shkëmbimi dhe sistematizimi i njohurive dhe praktikave në trajtimin e zvogëlimit të cenueshmërisë sizmike të mjedisit të ndërtuar në vendet partnere të projektit, për të harmonizuar planifikimin dhe menaxhimin e emergjencave pas ngjarjeve sizmike dhe fazës pas tërmetit, në mënyrë që të përmirësohet në mënyrë drastike. Qasjet për trajtimin dhe sigurimin e zvogëlimit të ndjeshmërisë sizmike midis rajoneve ADRION. Zonat kryesore të fokusit janë qendrat historike urbane dhe sheshet historike dhe ndërtesat e tyre përreth, të konceptuara si symbol i identitetit local dhe bërthamave socio-ekonomike për vendbanimet ADRION.

Duke u bazuar në njohuritë e disponueshme dhe në sajë të bashkëpunimit territorial, ADRISEISMIC do të zhvillojë qasje të reja të integruara për të përtërirë dhe harmonizuar kornizat normative, teknike dhe trajnimin në zonën ADRION, duke siguruar metoda, mjete dhe procedura të gatshme për përdorim që do të integrohen në politikat dhe praktikat ekzistuese, duke forcuar kështu përgjigjet lokale dhe duke zvogëluar cenueshmërinë ndaj rreziqeve natyrore.

Partneriteti përfshin 8 partnerë nga 6 vende (ITALIA (I.I.P.L.E-BOLONJE), KROACI (QYTETI I KASTELES), SLLOVENIA (INSTITUTI KOMBETAR I NDERTIMEVE DHE INXHINIERISE CIVILE SLLOVENE), GREQIA (UNIVERSITETI I KRETES-QARKU I KRETES), SHQIPËRIA (BASHKIA GJIROKASTER), SERBIA (AGJENSIA E ZHVILLIMIT RAJONAL “BACKA”). Ai përfshin bashkitë, autoritetet rajonale dhe agjencitë e zhvillimit si dhe universitetet, qendrat kërkimore dhe trajnuese.

Rezultatet kryesore të ADRISEISMIC do të përbëhen nga 2 plane veprimi dhe krijimi i një rrjeti bashkëpunimi ndërkombëtar.

Në veçanti, Bashkia e Gjirokastrës do të kontribuojë në mbledhjen, analizën dhe krahasimin e normave, teknikave dhe trajnimeve të ndryshme në lidhje me uljen e ndjeshmërisë sizmike në ndërtesat historike, të cilat do të çojnë në përcaktimin e një kornize të përbashkët dhe inovative. Prandaj, Gjirokastra do të ketë mundësinë të përfitojë nga harmonizimi i normave, metodave dhe teknikave innovative dhe programeve arsimore dhe kurseve të trajnimit që do të zhvillohen nga projekti, duke përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e aktorëve teknikë të përfshirë

Ky është "qyteti i njëmijë shkallëve" që përfshin qindra kulla, shtëpi të stilit otoman me çati të veçanta prej guri, ballkone prej druri dhe mure guri ndonjëherë të lara në të bardhë. Në të vërtetë qyteti ka 56 ndërtesa të cilat janë deklaruar si monumente kulture të kategorisë së parë dhe mbi 500 të kategorisë së dytë. Pas hyrjes në fuqi të reformës administrative-territoriale, Bashkia e Gjirokastrës përbëhet nga 6 ish-bashki, të gjitha të pasura me monumente kulturore dhe historike. Si rezultat, zhvillimi i këtij projekti në kuadër të mbrojtjes së kësaj trashëgimie

kulturore nga faktorë të paparashikueshëm konsiston në një nga përparësitë kryesore të Bashkisë.

Granti i Bashkimit Evropian për këtë projekt llogaritet në 85% në vlerën 59559.50. Kontributi i Bashkisë Gjirokastër llogaritet në 10510,50

Projekti do të implementohet në pesë faza të disbursimit të transheve për vitin 2021 dhe 2022.

Në zbatim të Udhëzimit nr 35, datë 21.09.2020 “Për kontrollin, rregjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare” njësitë e zbatimit të projektit në rastin konkret Bashkia Gjirokastër operon pranë degës së thesarit për çeljen e kapitullit 2 për financimet e huaja. Në zbatim të llogarive të çelura në bankat e nivelit të dytë të cilat janë në lekë edhe rritja e buxhetit nga granti i huaj do të bëhet në Lekë. Kursi i këmbimit do të përdoret 123.78 Lekë/euro.

ADRISEISMIC

Gr.00 Tit.08220 Kap.2 Art 231 për 500 000 Lekë.

Zbatimi i projektit Adriseismic është i shtrirë në dy vite, përkatësisht 2021 dhe 2022 i pasqyruar edhe në PBA 2022-2024. **Projekti** është në fazën e katërt të implementimit të tyre dhe po hyn në periudhën e pestë. Në diskutimet me Lead Partnere është trajtuar mundësia e shtyrjes së afateve të implementimit të dy projekteve respektivisht për arsye të pandemisë Covid, por deri për momentin nuk është kthyer asnjë përgjigje nga Autoriteti Menaxhues. Projekti ADRSEISMIC si dhe Projekti ADRINETBOOK kane kaluar 3 periudha çertifikimi nga te cilat janë çertifikuar ne total 18437.01 E nga 70070 E për projektin Adriseismic dhe 40406.13 E nga 183575 E për projektin Adrinetbook. Shuma të cilat pasi të mbahet kontributi i 15% te bashkisë dhe parafinancimi do të transferohen me pas nga Lead Partner në llogarinë Speciale të secilit projekt për implementim. Në fazën e tanishme këto dy projekte po procedojnë implementimin e tyre vetëm me parafinancimin. Për mbylljen në kohë dhe me sukses të projekteve implementimi projekteve brenda afateve buxheti 2022 parashikon angazhim të fondeve të veta në shumën 2 000 000 lekë.

- **Gr.00 Tit.08220 Kap.5 Art 231** Kosto ekspertize e jashtme : 500.000 ALL

- **Gr.00 Tit.08220 Kap.5 Art 231** Kosto pajisjeje scanner 1.500.000 ALL me Tvsh

“ADRINETBOOK”

Projekti i ADRINETBOOK synon promovimin, vlerësimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në zonën Adriatiko-Jon. Qëllimi i tij specifik është të kontribuojë në rritjen dhe konservimin e pronave specifike kulturore, në veçanti të librave, dhe të bëjë dixhitalizimin e kësaj trashëgimise, në mënyrë që të jetë e arritshme për një publik më të gjerë në zonën e projektit të Italisë, Sllovenisë, Kroacisë, Shqipërisë, Greqisë dhe Serbisë, përmes krijimit të një rrjeti midis operatorëve të sektorëve të kulturës dhe turizmit dhe trajnimin e tyre, përmes

dixhitalizimit të koleksione të zgjedhura, të kryera me standarde dhe metodologji të përbashkëta dhe të integruara në një platformë të përbashkët.

Në këtë mënyrë, projekti do të trajtojë sfidat e mëposhtme të përbashkëta:

- nevojën për bashkëpunim midis sektoreve publik dhe privat, si dhe midis të gjithë sektorëve të trashëgimisë kulturore,
- mungesën e specialistëve të trajnuar në fushën e modelit të qëndrueshëm të turizmit,
- domosdoshmëria e një strategjie të përbashkët për dixhitalizimin e pronave kulturore,
- treguesit statistikorë të ndarë në një mënyrë sistematike, mungesa e fondeve për trajnime dhe udhëtime profesionale, një grumbullim serioz i të dhënave,
- mungesa e një turizmi të njohur si markë për koleksionin Adrion;
- domosdoshmëria e njohjes së Europeana (Europeana është një platformë e cila funksionon me mijëra arkiva, librari dhe muze evropiane për të ndarë trashëgiminë kulturore për edukim dhe kërkim. Gjithashtu ajo mundëson aksesin për miliona libra, muzikë, punime arti dhe më shumë me kërkim të sofistikuar dhe mjete filtrimi për të ndihmuar në gjetjen e materialeve) në mesin e publikut të gjerë dhe profesionistëve dhe nevoja e njohurisë midis operatorëve për mundësitë e ofruara nga grumbullimi i burimeve dixhitale të CH.

Prandaj, rezultatet e projektit do të jenë struktura e rrjetëzimit midis operatorëve të sektorëve të kulturës dhe turizmit, dixhitalizimi, veprimet pilot dhe rritja e vizitorëve. Si pasojë, projekti do të kontribuojë në rritjen e ndërgjegjësimit mbi trashëgiminë e përbashkët në zonën Adriatiko-Joniane si një kornizë orientuese për veprimet individuale, në vlerësimin e kulturës trashëgimore brenda një emri të markës Adrion si dhe përmirësimi i "strukturës së njohurive" përmes dixhitalizimit.

Bashkia e Gjirokastrës përpos përpjekjeve për rigjallërimin e kësaj pjese të rëndësishme të jetës shoqërore, ka si qëllim edhe organizimin e aktiviteteve të mëdha. Implementimi i këtij projekti i jep perspektivë të rëndësishme këtij aspekti, duke sjellë kështu një atmosferë tjetër në qytet, në trashëgimi në të gjithë botën e UNESCO-s, dhe njëkohësisht ajo është një mënyrë e shkëlqyeshme për të promovuar të gjitha vlerat kulturore, historike, arkitektonike dhe vlerat shpirtërore të zonës.

Në zbatim të Udhëzimit nr 35, datë 21.09.2020 “Për kontrollin, rregjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare” njësitë e zbatimit të projektit në rastin konkret Bashkia Gjirokastrë operon pranë degës së thesarit për çeljen e kapitullit 2 për financimet e huaja. Në zbatim të llogarive të çelura në bankat e nivelit të dytë të cilat janë në lekë edhe rritja e buxhetit nga granti i huaj do të bëhet në Lekë. Kursi i këmbimit do të përdoret 123.78 Lekë/euro.

ADRINETBOOK

Gr.00 Tit.08220 Kap.2 Art 231 për 1 500 000 Lekë.

Në përfundim të periudhës 2022 implementimi i projekteve dhe mbyllja e tyre brenda afateve do të disbursojë fondet e BE në llogaritë e të ardhurave të veta të Bashkisë.

Programi 09120

Përshkrim i Përgjithshëm i Programit

Mbështetja e arsimit parashkollor dhe arsimit bazë, administrimin dhe rregullim i sistemit arsimor parashkollor në kopshte.

Kodi i Programit	Emri i Programit	Përshkrimi i Programit
09120	Arsimi parashkollor përfshirë dhe arsimin bazë	<ul style="list-style-type: none"> • Ndërtim dhe mirëmbajtje e strukturave shkollore • Mbulimi i pagave për mësuesit e kopshteve të fëmijëve dhe stafit mbështetës • Furnizimi dhe mbështetja me ushqim e kopshteve

Objektivat e programit 09120 për vitin 2022

9120.1 Funksionimi, mirëmbajtja dhe rehabilitimi i rregullt i infrastrukturës së arsimit bazë dhe parashkollor për të siguruar mjedisin e duhur të mësimdhënies;

9120.2 Funksionimi normal i të gjitha kopshteve duke siguruar ngrohje, shërbime komunitare dhe shërbime sanitare;

9120.3 Sigurimi i shërbimeve të kopshteve nën autoritetin e Bashkisë për 350 vende;

9120.4 Sigurimi i ushqimeve ditore për 350 fëmijë në kopshte gjatë gjithë vitit arsimor;

Programi 09120 si një nga programet më të mëdha që administron Bashkia Gjirokastër ka në përbërjen e vet një staf prej 133 punonjësish. Buxheti 2022 parashikon fond për pagat (Ilog eko. 600) dhe sigurimet (Ilog eko. 601) në shumën 100 509 000 Lekë. Në planifikimin e pagave është marrë në konsideratë vetëm vjetërsia e punonjësve.

Transferta e pakushtëzuar sektoriale për vitin 2022 shkon në vlerën 107 557 000 lekë. Këtë vit transfera e pakushtëzuar vjen e ndarë në fondin e akorduar për personelin mësimdhënës dhe atë mbështetës.

Planifikimi i pagave në masën 100 509 000 lekë zë 81% të shpenzimeve të përgjithshme të programit. Duke marrë në konsiderat mesatarisht 300 fëmijë të rregjistruar për vitin shkollor 2021-2022 kostua për një fëmijë shkon në vlerën 287 168 lekë , vlerësuar kjo vetëm për koston administrative të shpenzimeve për personelin.

Si një pjesë e pandarë e ofrimit të shërbimit të mësimdhënies në arsimin parashkollorë është edhe pajisja e klasave të kopshteve me materiale didaktike dhe trajnimi i stafit me programin e zhvillimit të vazhdueshëm. Gjatë vitit 2022 do të mbështetet me fond buxhetor në vlerën 110 000 lekë të shërbimit të internetit, 400 000 lekë për materiale didaktike në kopshte.

Realizimi i objektivit të parë mbi funksionimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e infrastrukturës së arsimit bazë parashkollor me qëllim sigurimi e një mjedisi të duhur mësimdhënies, varet drejtë për së drejti nga realizimi i produktit të mirëmbajtjes rutinë të klasave në kopshte. Në varësi të Drejtorisë së Arsimit janë 12 godina të arsimit parashkollorë. Mirëmbajtja rutinë nënkupton riparime ose në disa raste zëvendësim të tavolinave, karrigeve, dollapëve, dritareve, bravave, lavamanëve, dhe materialeve të buta. Për realizimin e objektivit të parë në produktin e parë të këtij objektivit është parashikuar fondi në shumën 800 000 Lekë. Fond ky që do të shkojë për mirëmbajtje rutinë. Përveç mirëmbajtjes rutinë, një produkt tjetër i objektivit të parë është edhe rikonstruksioni i godinave duke aplikuar edhe eficienten energjitike si një nga standardet kryesore. Për vitin 2022, projekt buxheti parashikon 2 138 000 Lekë investim në një nga kopshtet më të frekuentuar, atë të “Cicërima”-ve.

Si një produkt tjetër i objektivit 9120.1 mjaft i rëndësishëm është edhe sigurimi i ndërtesave të kopshteve nga zjarri dhe tërmeti me minimumin 1% të vlerës së ndërtesës. Në projekt buxhetin 2022 parashikohet një fond në shumën 100 000 Lekë për ndërtesat e parashkollorit.

Po në kuadrin e sigurisë së ndërtesave dhe të jetës produkt i objektivit 9120.1 është gjithashtu pajisja e të gjithave kopshteve me kamerat e sigurisë minimumi dy copë sipas specifikimeve teknike të përcaktuar në ligj. E llogaritur kjo me kosto për cdo objekt që është planifikuar për tu pajisur me kamera shkon në vlerën 1 000 000 Lekë.

Në mbështetje të objektivit të dytë të programit për arsimin parashkollorë si produkt i tij është sigurimi i ngrohjes qendrore në kopshte. Shërbimi i ngrohjes me dru ofrohet në 7 kopshte. Në godinat e tjera të arsimit parashkollorë shërbimi i ngrohjes ofrohet me kalaja të cilat funksionojnë me lëndë djegëse naftë.

Përveç shërbimit të ngrohjes një shërbim tjetër i rëndësishëm është edhe sigurimi i ndërtesave arsimore me shërbime utilitare (furnizimi me energji elektrike dhe ujë). Gjatë vitit 2022 mbi bazën e kontratëve të energjisë elektrike, planifikimi për shërbimin utilitar të energjisë elektrike shkon në vlerën 2 100 000 Lekë. Gjithashtu për ofrimin e shërbimit utilitar të ujit po mbi bazën e kontratave të ujit planifikimi për vitin 2022 shkon në vlerën 2 000 000 Lekë.

Një shërbim tjetër i ofruar është edhe dezinfektimi i ambienteve të kopshteve. Për këtë shërbim është planifikuar shuma 144 000 Lekë për 3D për një sipërfaqe 5 960 m² dhe 24 000 për analizat e ujit.

Si objektivi i fundit për këtë program por jo më i parëndësishmi është ofrimi i shërbimit të vakteve ushqimore në kopshte. Produkte të këtij objektivi janë; ushqim i ofruar për mesatarisht 300 fëmijë, shpërndarja e ushqimit në ato kopshte që nuk kanë kuzhinë dhe mirëmbajtja e kuzhinave. Planifikimi për vitin 2022 vetëm për trajtimin ushqimor shkon në vlerën 10 925 000Lekë .

Kosto për shpërndarjen e ushqimit shkon në vlerën 3 340 000 Lekë, nga të cilat 3 000 000 Lekë shkojnë vetëm për karburant. Drejtoria e Arsimit ka në administrim të vet 3 mjete për të cilat kostua e mirëmbajtjes shkon në vlerën 340 000 Lekë. Përveç ofrimit rutinë të shërbimit buxheti 2022 planifikon blerjen e një mjeti të ri transporti në vlerën 1 000 000 Lekë.

Të Dhëna Bazë mbi Programin 09120

	Të Përgjithshme	2017	2018	2019	2020	2021
Numri i punonjësve të programit		193	193	193	183	184
Numri i shkollave të arsimit		11	11	11	11	11
Qytet		5	5	5	5	5
Njwsi Administrative		6	6	6	6	6
Numri i fëmijëve në kopshte		0	562	532	645	643
Qytet			562	532	482	480
Njwsi Administrative					163	163
Numri i kopshteve		20	20	20	20	20
Qytet		7	7	7	7	7
Njwsi Administrative		13	13	13	13	13
Numri i fëmijëve në çerdhe		0	95	87	84	84
Qytet			95	87	84	84
Njwsi Administrative		0	0	0	0	0
Numri i Çerdheve		1	1	1	1	1
Numri i fëmijëve në moshë shkollimi		150	170	155	180	187
Qytet		110	125	120	130	136
Njwsi Administrative		40	45	35	50	51
Mwësues në sistemin parashkollor				73	73	73
Numri i klasave në sistemin parashkollor		36	36	36	36	36

BUXHETI 2022

Raport		Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike			
Bashkia	GJIROKASTËR				
Programi	09120	Arsimi parashkollor përfshirë arsimin bazë			
Shpenzimet e Programit (000 ALL)					
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2019	2020	2021	2022
		Fakt	Fakt	Buxh. Fillest.	Plani
Paga dhe Sigurime					
Paga	600	77,234.0	76,732.0	81,888.0	86,709.0
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	601	13,065.0	12,811.0	13,025.0	13,800.0
Korente					
Mallra dhe Shërbime	602	17,205.0	16,584.0	20,553.0	18,271.0
Subvencion	603	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta të Brendshme	604	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta të Jashtme	605	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta për Familje & Individë	606	289.0	444.0	0.0	0.0
Shpenzime Kapitale					
Aktive të Paprekshme	230	0.0	0.0	0.0	0.0
Aktive të Prekshme	231	35,734.0	0.0	4,335.0	5,972.0
TOTALI		143,527.0	106,571.0	119,801.0	124,752.0

Programi 09230**Përshkrim i Përgjithshëm i Programit**

Mbështetja e arsimit parashkollor dhe arsimit bazë, administrimin dhe rregullim I sistemit arsimor parashkollor në kopshte.

Kodi i Programit	Emri i Programit	Përshkrimi i Programit
09120	Arsimi parauniversitar	<ul style="list-style-type: none"> • Ndërtim dhe mirëmbajtje e strukturave shkollore; • Ndërtim rehabilitim dhe miëmbajtje e ndërtesave arsimore e sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale. Mbulimi i pagave për mësuesit e kopshteve të fëmijëve dhe stafit mbështetës • Shpenzim për pagat e stafit mbështetës. • Mbështetje për trajnim të mëtejshëm të mësuesve.

BUXHETI 2022					
Raport	Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike				
Bashkia	GJIROKASTËR				
Programi	09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm			
Shpenzimet e Programit (000 ALL)					
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2019	2020	2021	2022
		Fakt	Fakt	Buxh. Fillest.	Plani
Paga dhe Sigurime					
Paga	600	21,384.0	24,411.0	25,172.0	25,450.0
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	601	3,412.0	4,139.0	4,006.0	4,023.0
Korente					
Mallra dhe Shërbime	602	11,953.0	17,618.0	12,312.0	11,102.0
Subvencion	603	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta të Brendshme	604	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta të Jashtme	605	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta për Familje & Individë	606	62.0	1,075.0	0.0	0.0
Shpenzime Kapitale					
Aktive të Paprekshme	230	0.0	0.0	0.0	0.0
Aktive të Prekshme	231	21,924.0	0.0	2,000.0	12,564.0
TOTALI		58,735.0	47,243.0	43,490.0	53,139.0

BUXHETI 2022					
Raport	Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike				
Bashkia	GJIROKASTËR				
Programi	10140	Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara			
Shpenzimet e Programit (000 ALL)					
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2019	2020	2021	2022
		Fakt	Fakt	Buxh. Fillest.	Plani
Paga dhe Sigurime					
Paga	600	7,334.0	5,405.0	7,173.0	9,440.0
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	601	1,256.0	835.0	1,162.0	1,506.0
Korente					
Mallra dhe Shërbime	602	1,874.0	3,216.0	2,342.0	3,401.0
Subvencion	603	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta të Brendshme	604	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta të Jashtme	605	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta për Familje & Individë	606	333.0	638.0	700.0	1,200.0
Shpenzime Kapitale					
Aktive të Paprekshme	230	0.0	0.0	0.0	0.0
Aktive të Prekshme	231	0.0	0.0	0.0	0.0
TOTALI		10,797.0	10,094.0	11,377.0	15,547.0

Qëllimi i programit 09230 është rritja e nivelit të ndjekjes së arsimit parauniversitar nga grupmosha 15-18 vjeç, nga (96%) në 2021 në (97.6%) deri në vitin 2028 duke siguruar shërbime të arsimit cilësor për të gjithë nxënësit deri në 2028 në përputhje me 'Standardet e Qëllimit'

Objektivat, produktet dhe aktivitetet e programit 09230 janë;

1. Rritja e numrit të shkollave që përmbushin standardet arsimore të mjedisit fizik (nga 95% në 97%).
 - a) Ndërtimi i klasave të laboratoreve shkencorë në shkollat pa laboratorë shkencorë.
 - b) Rishikoni kalendarin ekzistues për ndërtimin e laboratorit shkencor.
 - c) Drejtoni procesin e prokurimit për ndërtimin e laboratorit shkencor.
 - d) Monitorimi i ndërtimit të laboratorit
2. Shkolla të adaptuara për qasje për nxënësit me aftësi ndryshe.
3. Funkionimi, mirëmbajtja dhe rehabilitimi i rregullt i infrastrukturës së arsimit parauniversitar për të siguruar mjedisin e duhur të mësimdhënies.

4. Mirëmbajtja e jashtme e ndërtesave njëkatëshe të objektit të vetëm në përputhje me standartet.
5. Rikonstruksioni i ndërtesave shkollore me një objekt të vetëm në përputhje me kriteret e vendosura në ligj.
6. Sigurimi i ndërtesave të shkollës nga rreziku i zjarrit dhe tërmetit.
7. Funkcionimi normal i të gjitha mjediseve të shkollës duke siguruar ngrohje, shërbime të ndihmës së shpejt, shërbime komunitare dhe sanitare.
8. Sigurimi i ndërtesave arsimore me shërbime utilitare (furnizimi me energji elektrike dhe ujë).
9. Ndërtesat arsimore që realizohet shërbim dezinfektimi të paktën një herë në muaj.
10. Sigurimi i medikamenteve për ndërhyrjen e shpejtë të lëndimeve të lehta në të gjitha për klasat e shkollave.
11. Trajnim një javor për shëndetin, sigurinë dhe përmbajtjen mësimore për sigurinë nga tërmeti, dhënë 24 stafit mbështetës.

Programi 10140

Përshkrim i Përgjithshëm i Programit		
Krijimi dhe administrimi I shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuar, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj,... sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.		
Kodi i Programit	Emri i Programit	
10140	Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuar	

BUXHETI 2022					
Raport		Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike			
Bashkia		GJIROKASTËR			
Programi		10140	Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara		
Shpenzimet e Programit (000 ALL)					
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2019	2020	2021	2022
		Fakt	Fakt	Buxh. Fillest.	Plani
Paga dhe Sigurime					
Paga	600	7,334.0	5,405.0	7,173.0	9,440.0
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	601	1,256.0	835.0	1,162.0	1,506.0
Korente					
Mallra dhe Shërbime	602	1,874.0	3,216.0	2,342.0	3,401.0
Subvencion	603	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta të Brendshme	604	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta të Jashtme	605	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta për Familje & Individë	606	333.0	638.0	700.0	1,200.0
Shpenzime Kapitale					
Aktive të Paprekshme	230	0.0	0.0	0.0	0.0
Aktive të Prekshme	231	0.0	0.0	0.0	0.0
TOTALI		10,797.0	10,094.0	11,377.0	15,547.0

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Bashkia Gjirokastër krijon, administron dhe ushtron funksione dhe kompetenca në interes të komunitetit. Buxheti i vitit 2022 i ka dhënë prioritet shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, për personat me aftësi të kufizuar, për fëmijët e braktisur, të dhunuar të çdo pakicë kombëtare etj. Duke marrë në konsideratë se vlera e ndihmës ekonomike do të rritet për vitin 2022, duke u bazuar në mendimin më të fundit të qeverisë fondi limit për vitin 2022 do të shkojë në shumën 1 200 000 Lekë nga 700 000 Lekë që ishte në vitin 2021.

Në mbështetje të ligjit 22/2018 “Për strehimin social” buxheti 2022 parashikon subveccion qeraje në shumën 1 614 000 Lekë.

Programi 10140 administron edhe një projekt e bashkëfinancim nga MSHMS dhe Bashkisë Gjirokastër me objekt **“Ofrimi i shërbimeve për viktimat e dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Gjirokastër ”**

Qendra e Emergjencës 72 orëshe për të gjitha kategoritë viktime të dhunës në familje do të jetë një shërbim i qëndrueshëm dhe afatëgjatëqë do të bëjë të mundur ofrimin e të gjitha shërbimeve

përviktimat e dhunës apo në risk ndaj saj. Me situatën në të cilën kjo kategori ndeshet është e rëndësishme mbështetja për shërbime, duke zbutur sadopak efektet e krizës social-ekonomike, psiko-emocionale, traumat e momentit, por edhe ato të mëvonshme.

Rezultatet e pritshme përfshijnë a) shërbime mirëfunksionale në dobi të viktimave të dhunës në 24 orë në 7 ditë të javës, që mundësojnë një mbulim gjeografik më të gjerë për Bashkinë Gjirokastrë b) forcimin e viktimave të dhunës dhe të atyre në risk si dhe i atyre që i mbështesin ato që të mos vuajnë në heshtje, por të kërkojnë ndihmë në numrin e publikuar të bashkisë c) fuqizimin e dhënies së shërbimeve nga Bashkia d) ofrimin e shërbimeve në mënyrë të përkohshme në varësi të nevojave të identifikuar dhe të zgjedhura nga përfituesit, viktimat të dhunës në familje që kanë marrë Urdhër Mbrojtje apo Urdhër të menjëhershëm mbrojtje dhe siguron: a) strehimin; b) sigurinë fizike; c) ushqimin; ç) kujdesin shëndetësor; d) asistencë juridike; dh) rehabilitimin psiko-social; si dhe e) fuqizim për punësim.

Përshkrim i situatës dhe arsytimi i propozimit

Bashkia Gjirokastrë ka një sipërfaqe prej 470.1 km² me një dendësi popullore 110.9 banor /km². Bashkia është e organizuar në 7 njësi administrative: Gjirokastrë, Cepo, Picar, Lunxhëri, Antigone, Odrie dhe Lazarat dhe përfshin në territorin e saj 52,016 banorë¹ me një shpërndarje 65% e popullsisë jeton në zonë urbane dhe 35% e popullsisë jeton në zonë rurale.

Nga 16.520 familjegjithsej në Bashkinë Gjirokastrë, 11.293 familje banojnë në zonë urbane (68% e familjeve) dhe 5.227 familje jetojnë në zonën rurale (32% e familjeve).

Sipas të dhënave të raportuara nga Policia, gjatë vitit 2018 në 59 raste është kërkuar ndërhyrja e policisë për rastet e dhunës në familje. Sipas Bashkisë Gjirokastrë gjatë vitit 2018 janë shënuar 34 raste me urdhër të menjëhershëm mbrojtje dhe 25 raste me urdhër mbrojtje. Në 80% të rasteve viktimë e dhunës në familje ishte grua, në 20% të rasteve viktimë e dhunës ishte burrë.

Specifikisht: 34 raste me urdhër të menjëhershëm mbrojtje ku viktimat ishin gra, 14 raste me urdhër mbrojtje, viktimat ishin burra, 3 raste me urdhër mbrojtje, viktimat ishin burra, 2- raste me urdhër mbrojtje/menjehershëm mbrojtje ku viktimat të tyre ishin fëmijë. Edhe gjatë vitit 2019 për periudhën janar-prill janë paraqitur me “urdhër mbrojtje” 9 raste ku 2 (dy) prej tyre kanë qënë meshkuj. Por ende problem ngelet mosdenoncimi i rasteve të dhunës në të gjitha format që ajo

shfaqet si ekonomike, psikologjike, fizike, seksuale dhe emocionale. Nga koordinatori kundër dhunës në familje dhe barazisë gjinore, Bashkia Gjirokastrë ofrohet Informim dhe keshillim për viktimat e dhunës në familje dhe barazisë gjinore duke organizuar aktivitete dhe fushata sensibilizuese për parandalimin e dhunës në familje, si dhe menaxhimin e rasteve sipas nevojës. Viktimat e dhunës me bazë gjinore janë gra dhe vajza të të gjitha moshave, grupeve sociale dhe arsimore apo profesioneve të ndryshme. Megjithatë, grupet më vulnerabel mbeten gratë që vijnë nga familje me nivel të ulët arsimor, me probleme të theksuara social-ekonomike, familje në të cilat bashkëshortët janë konsumatorë të pijeve alkoolike, gratë kryefamiljare dhe vajzat, veçanërisht ato që vijnë nga zonat e ndryshme rurale por edhe të zonave të tjera të qarkut gjirokastrë. Në shumicën e rasteve dhunuesit janë burra, të cilët njihen nga viktimat: anëtarë të familjes, të afërm, bashkëjetues, prindër, ish-bashkëshort, fëmijë, etj. Dhuna në familjemetet një nga format më të zakonshme ku janë shënuar edhe viktimat.

Duke marrë parasysh përmasat e dhunës në familje, një problem mjaft i prekshëm mbetet fakti që kapaciteti i shërbimeve për viktimat e kësaj dhune në Bashkinë Gjirokastrë është i ulët dhe rastet menaxhohen vetëm nga koordinatori kundër dhunës në familje dhe barazisë gjinore.

Me vendim të Këshillit Bashkiak, datë 24 maj 2018 është miratuar vendimi nr 49 për “Ofrimin e shërbimeve në mbështetje të viktimave të dhunës në familje”.

Në bazë të këtij vendimi kjo kategori përfiton falas për periudhën e urdhërit të mbrojtjes a) shërbimin e transportit publik brenda territorit të bashkisë, b) ofrimin e shërbimit falas për fëmijët që frekuentojnë çerdhet/ kopshtet c) përjashtimin nga pagesa për lëshimin e dokumenteve (vërtetimeve) nga Bashkia dhe Agjencitë në varësi të saj. Në territorin e Bashkisë Gjirokastrë nuk ka OJF të ndryshme që operojnë në këtë fushë.

Qëllimi dhe objektivat specifike të projektit

Qëllimi i ndërhyrjes së propozuar është të sigurojë ofrimin e shërbimeve të mbështetjes psiko-emocionale, ndihmës ligjore, dhe referimit në shërbim mjekësor, të punësimit dhe të strehimit falas për gratë dhe vajzat e dhunuara dhe atyre në risk duke zbutur sadopak efektet e krizës që shkakton dhuna.

Për të arritur këtë, përpjekjet e ndërhyrjes së propozuar do të fokusohen në dhënien e shërbimit, ndërgjegjësim dhe ngritje kapacitetesh. Kështu projekti do të punojë për:

- Të siguroar ofrimin e shërbimeve të mbështetjes psiko-emocionale, ndihmës ligjore, referimit në shërbim mjekësor, të punësimit dhe të strehimit falas për të gjitha kategoritë viktime të dhunës.
- Të informojë viktimat e dhunës me baza gjinore, si dhe gratë dhe burrat që i përkrahin ose janë në kontakt me to, se ku të adresohen kur kanë nevojë për ndihmë, si dhe të rrisë besimin e tyre tek këto shërbime.
- Të rrisë ndërgjegjësimin e komunitetit, shoqërisë dhe medias për denoncimin dhe referimin e rasteve të dhunës.
- Të mbledhë dhe përpunojë në mënyrë sistematik dhe të rregullt të dhënat për llojin dhe shtrirjen e dhunës me bazë gjinore dhe përcjelljes së këtij informacioni tek publiku.
- Të përcaktojë një sistem të brendshëm vlerësimi dhe monitorimi për një mënyrë të përhershme përmirsimi ashtu sic nevojitet;
- Forcimine bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet të gjithë aktorëve (qeveritare dhe joqeveritare) që, sipas ligjit “Për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”, kanë përgjegjësi ose kontribuojnë në ofrimin e këtyre shërbimeve.

Metodologjia

Përshkrimi i metodologjisë që do zbatohet për arritjen e rezultateve

Bashkia Gjirokastër parashikon që ky proces të ndodh në disa faza që përfshijnë a) ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës në familje, b) rritjen e ndërgjegjësimit për dhunën në familje, si pjesë e strategjisë së parandalimit dhe fuqizimit të viktimave, c) ngritje kapacitetesh për ofruesit e shërbimeve në këtë fushë, d) menaxhimin e rasteve në tryeza multidisiplinare, si dhe ç) krijimin e një mjedisi të sigurtë për jetën dhe riintegrimin e tyre.

Aktivitetet e ndërgjegjësimit nga ana tjetër do t'i lejojnë përfituesve të mësojnë se cilat janë shërbimet nga të cilat ata mund të përfitojnë si dhe të edukojnë anëtarë të komunitetit dhe median për statusin dhe rolin e e kësaj qendre.

Përveç këtyre rezultateve, përpjekjet e ndërgjegjësimit, mbështetjes dhe inkurajimit për të denoncuar çdo formë dhune

Nën strategjinë e ndërtimit të kapaciteteve fokusi do të jetë në aplikimin e standarteve të njëjta në dhënien e shërbimit, monitorimit dhe vlerësimit si dhe në bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit. Bashkë me përmirsimin në menaxhimin e burimeve dhe në ngritjen e fondeve si dhe më përpjekjet e advokimit në mbështetje të viktimave të dhunes ne familje, rezultatet përfundimtare të kësaj strategjie do të jenë sigurimi i qëndrueshmërisë së shërbimeve për viktimat e dhunës dhe ato në risk, që ofrohen nga këto shërbime.

Rezultatet e pritshme dhe monitorimi i progresit

- a) Sigurimi i shërbimeve për viktimat e dhunës mbi baza gjinore përmes Bashkisë Gjirokastër për viktimat e dhunës 7 ditë të javës, 24 orë në ditë duke ju lejuar viktimave ofrimin e mbështetjes së pritshme për viktimat e dhunes ne familje dhe për ato në risk.
- b) Fuqizimi i viktimave të dhunes ne familje dhe atyre në risk si dhe i atyre që i mbështesin për të mos vuajtur në heshtje por për të kërkuar ndihmë dhe besim në dhënësit e shërbimeve.
- c) Forcimi i kapaciteteve në dhënien e një shërbimi profesional dhe të menjëhershëm.

Indikatorët më të rëndësishëm të përzgjedhur për matjen e rezultateve të projektit janë si me poshtë

Indikatorët e rezultateve:

1. Rritja e numrit të viktimave të dhunës në familje që marrin shërbime tek Bashkia
2. Rritja e përqindjes së këshilluesve të trajnuar të cilët raportojnë se përdorin me viktimat e dhunës teknikat e reja të marra nga programet e trainimit.
3. Rritja e përqindjes së viktimave të dhunës në familje të cilat ndjejnë se u janë ofruar shërbimet e duhura që i ndihmojnë ato për tranzicionin e tyre.
4. Rritja e përqindjes së personave, pjesëmarrës në aktivitetet për ndergjegjësim, të cilët artikulojnë mesazhe të transmetuara gjate ketyre aktiviteteve.

Në të njëjtën kohë do të vlerësohet “Mendimi i viktimave të dhunës” përsa i takon efektivitetit të shërbimeve të ofruara bazuar kjo në 3 shkallë të pëlqyeshmërisë (të pavlefshme ,të vlefshme, shumë të vlefshme) e cila do të ndihmojë për të klasifikuar shërbimet për vlefshmërinë dhe rëndësinë e tyre.

Shuma e akorduar nga Buxheti 2022 në favor të projektit me bashkëfinancim shkon në vlerën 8 000 000 Lekë.

Buxheti 2022 është i orientuar drejt produktit për rritjen e cilësisë së shërbimeve, zhvillimin ekonomik-social në komunitet. Planifikimi i buxhetit është bërë mbi bazën e përcaktimit të politikave të programeve dhe objektivave specifike të matshëm, përmes treguesve sasior dhe cilësor, të lexueshëm dhe të monitorueshëm lehtësisht në çdo kohë. Për të siguruar implementimin dhe arritjen e objektivave strategjike dhe zhvillimore buxheti 2022 lidhet me kontekstin afatmesëm për vitin 2022-2023. Ky buxhet do të sjelli risi në rritjen e burimeve financiare si nga pushteti qendror ashtu edhe nga donator të huaj.

Rriti shpenzimet kapitale nga 81 214 mijë në vitin 2021 në 175 028 mijë për vitin 2022. Buxheti 2022 i jep prioritet infrastrukturës së rehabilitimit të hapësirave publike, punëve publike, menaxhimit të mbetjeve, mobilimit urban dhe asaj së kulturës dhe trashëgimisë kulturore.
